



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

**Menaxhimi i Projekteve për
Sistemet e Teknologjisë së
Informacionit në Agjencinë e
Shoqërisë së Informacionit**



Prishtinë, korrik 2023

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare. Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000¹) dhe Udhëzuesin për Auditimin e Sistemeve të Informacionit (GUID 5100²) si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditimet e teknologjisë së informacionit të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë një ekzaminim dhe rishikim i sistemeve të Teknologjisë së Informacionit dhe kontrolleve përkatëse për të fituar siguri mbi parimet e ligjshmërisë, efikasitetit³, ekonomisë⁴, dhe efektivitetit⁵ të sistemit të Teknologjisë së Informacionit dhe kontrolleve përkatëse.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me këtë raport të auditimit “Menaxhimi i Projekteve për Sistemet e Teknologjisë së Informacionit në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit” në konsultim me Ndhmës Auditoren e Përgjithshme Myrvete Gashi Morina, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që realizoi këtë raport:

Samir Zymberi, Drejtor i departamentit të auditimit;
Shqipe Mujku Hajrizi, Udhëheqëse e ekipit; dhe
Poliksena Berisha, Anëtare e ekipit

¹SNISA 3000 – Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike

²GUID 5100 – Udhëzuesi për auditimin e sistemeve të informacionit lëshuar nga INTOSAI

³ Efikasiteti – Parimi i efikasitetit nënkupton të marrësh maksimumin nga resurset në dispozicion. ka të bëjë me lidhshmërinë ndërmjet resurseve të angazhuara dhe rezultateve të dhëna në kuptim të sasisë, cilësisë dhe kohës

⁴ Ekonomia – Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së resurseve. Resurset e përdorura duhet të jenë në dispozicion me kohë, në sasi dhe cilësi të duhur dhe me çmimin më të mirë

⁵ Efektiviteti – Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritura.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	5
1. Hyrje.....	7
2. Objektivi dhe fushat e auditimit	10
3. Gjetjet e auditimit.....	11
4. Konkluzionet	26
5. Rekomandimet	28
Shtojca I. Dizajni i auditimit	30
Fushat me rrezik dhe motivi i auditimit	30
Përshkrimi i sistemit.....	31
Fushëveprimi dhe pyetjet e auditimit.....	35
Kriteret e auditimit	36
Metodologjia e Auditimit	37
Shtojca II. Lista e projekteve që janë audituar	39
Shtojca III. Letërkonfirmimi	40

Lista e shkurtesave

ARC	Agjencia e Regjistrimit Civil
MAP	Ministrisë për Administratë Publike
MPB	Ministrisë së Punëve të Brendshme
AShI	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
IRK	Institucion i Republikës së Kosovës
QDhSh	Qendra e të Dhënave Shtetërore
TI	Teknologjia e Informacionit
KASH	Kornizën Afatmesme e Shpenzimeve
GIS	Geographic Information System (Sistemi Informativ Gjeografik)
SISh	Sistemi Informativ Shëndetësor
PAKS	Sistemi i Arkivimit dhe Komunikimit të Imazheve (Picture Archiving and Communication System)
SIMBNj	sistemin për menaxhimin e burimeve njerëzore
MAShT	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
OE	Operator Ekonomik
SIEM	Siguri, Informim dhe Menaxhimi i ngjarjeve (Security, Information and Event Management)
VOIP	pSistem telefonik nëpërmjet Protokolit të Internetit (Voice Over Internet Protocol)
PhD	Doktor i Shkencave Filozofike - Doctors of Philosophy

Përmbledhje e përgjithshme

Agjencia e Shoqërisë së Informacionit është organ qendror i administratës shtetërore që ka përgjegjësi për zhvillimin, zbatimin, mbikëqyrjen e proceseve të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në institucionet e Republikës së Kosovës.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e Teknologjisë së Informacionit për të vlerësuar se si Agjencia e Shoqërisë së Informacionit menaxhon projektet e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe sa është efektive në vlerësimin e projektit përfshirë procesin e inicimit, planifikimit, zbatimit dhe monitorimit.

Rezultatet e auditimit kanë treguar se Agjencia e Shoqërisë së Informacionit në vazhdimësi (përfshirë edhe periudhën e pandemisë Covid 19) ka zhvilluar projekte të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit me qëllim të digjitalizimit të shërbimeve dhe lehtësimit në qasjen e tyre për institucionet shtetërore dhe qytetarët përmes platformave elektronike. Mirëpo Agjencia nuk ka arritur të jetë efektive në realizimin e këtyre projekteve.

Procesi i zhvillimit të projekteve të teknologjisë së informacionit nuk është menaxhuar mirë nga Agjencia. Kjo ka ndikuar në mosrealizimin e shërbimeve, në mostrajtimin e duhur të sigurisë së informacionit, duke ndikuar edhe në shpenzime të pa nevojshme dhe dëmtim të buxhetit.

Menaxhmenti i Agjencisë nuk ka siguruar qeverisje të mirë të teknologjisë së informacionit. Nuk ka bërë një analizë të mjaftueshme për të identifikuar nevojat dhe zgjidhur problemet me projektet e reja dhe me prioritet. Ka mungesë të planit të menaxhimit të rrezikut, vonesa në zbatimin e projekteve, orientim jo të mirë të buxhetit dhe është ekspozuar ndaj rrezikut me ndaljen e shërbimeve të internetit për institucionet e Republikës së Kosovës. Mangësitë e zbatimit të projekteve që janë të ndërlidhura në mes veti si dhe ndërmjet institucioneve kanë ndikuar në rritjen e shpenzimeve për këtë fushë në nivel vendi.

Në zhvillimin e projekteve Agjencia ka mangësi në monitorimin dhe komunikimin me palët e interesit në institucionet e Republikës së Kosovës, si dhe nuk ka bërë një vlerësim të rreziqeve dhe planifikim të veprimeve për t'i parandaluar apo zvogëluar ato. Kjo ka ndikuar në mosrealizimin e shërbimeve sipas planit të projektit, si dhe ka paguar rreth 506 mijë euro për shërbime dhe licenca që nuk janë realizuar dhe shfrytëzuar.

Agjencia nuk e ka trajtuar me kujdes sigurinë e informacionit, duke shkaktuar paqartësi në raste të klasifikimit të informacioneve dhe shpалosjen e tyre pa i vlerësuar dhe deklasifikuar ato paraprakisht. Nuk ka specifikuar kërkesën për kufizimin e trafikut nga interkoneksionet rajonale të pasigurta për vendin tonë. Gjithashtu, nuk ka zbatuar nënshkrimin e deklaratës së konfidencialitetit për të gjithë stafin e operatorëve ekonomik që kanë qasje në informacionin dhe infrastrukturën shtetërore të teknologjisë së informacionit.

Me qëllim të adresimit të çështjeve të identifikuara lidhur me menaxhimin e projekteve të sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ne kemi dhënë 18 rekomandime për Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit.

Përgjigja e entitetit

Ministria e Punëve të Brendshme përkatësisht Agjencia e Shoqërisë së Informacionit është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

1. Hyrje

Agjencia për Shoqërinë e Informacionit (AShI) është themeluar si agjenci ekzekutive qeveritare në dhjetor të vitit 2013, në kuadër të Ministrisë për Administratë Publike (MAP).⁶ Nga viti 2020 me riorganizimin e ministrive MAP kalon në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), ASH-i-tani është agjenci në kuadër të MPB-së.

ASH-i-tani në bazë të akteve ligjore dhe rregullative, ka përgjegjësi për përpilimin dhe koordinimin e politikave të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) për institucionet e Republikës së Kosovës (IRK). ASH-i-tani udhëheq dhe mbikëqyrë proceset dhe mekanizmat e e-qeverisjes në lidhje me infrastrukturën e TIK-ut, zgjerimin e shërbimeve të internetit, menaxhimin e qendrës shtetërore të të dhënave elektronike, sigurinë dhe mbrojtjen e infrastrukturës së TIK-ut, udhëheqjen dhe monitorimin e projekteve të TIK-ut, etj.

ASH-i-tani ka zhvilluar dhe mirëmban rrjetin shtetëror që ndërlidhet me institucionet e Republikës së Kosovës. Në këtë rrjetë janë të lidhura rreth 1,100 objekte shtetërore me rreth 10,000 pajisje për të mundësuar ofrimin e shërbimeve për të gjitha IRK-të. Numri i përdoruesve të kyçur në rrjetin shtetëror është 15,000. Unaza e rrjetit fibrik lidh institucionet regionale/lokale publike në qytetet më të mëdha. E njëjta teknologji përdoret për të lidhur pothuajse të gjitha institucionet qeveritare qendrore. Komunitet tjera dhe zonat e thella rurale përgjithësisht janë të lidhura me mikro-valë ose përmes huazimit të rrjeteve nga ofruesit e shërbimeve private të Internetit dhe tunelimit të shërbimeve përmes VPN (Virtual Private Network (Rrjet Privat Virtual)).⁷




Figura 1. Rrjeti shtetëror në Republikën e Kosovës⁸


⁶ Ligji nr. 04/L-145 për Organet Qeveritare të Shoqërisë së Informacionit

⁷ Raport nga Drejtoritë e Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit.

⁸ Raport nga Drejtorati i Rrjetit dhe Telekomunikimit dhe Drejtorati i zhvillimit të e-Qeverisjes, ASH-i.

AShI-ja menaxhon edhe Qendrën e të Dhënave Shtetërore (QDhSh) që posedon më shumë se 400 serverë virtual, që përdoren nga IRK-të. Në serverët e vendosur në QDhSh ka numër të madh të shërbimeve që janë të hostuara dhe që shërbejnë për të gjitha IRK-të. Numri i përdoruesve të kyçur në domenin qeveritar është rreth 13,000.⁹

AShI-ja ka për qëllim digjitalizimin e shërbimeve dhe lehtësimin në qasjen e shërbimeve të IRK-ve përmes platformave elektronike. Nga viti 2014 deri në vitin 2022 AShI-ja ka realizuar investime të vazhdueshme në TIK dhe janë realizuar dhe menaxhuar rreth 53 kontrata¹⁰. Vlera e kontratave të lidhura me operatorët ekonomik për investime në TIK është mbi 32 milionë euro. Investimet kryesisht janë drejtuar në blerjen dhe mirëmbajtjen e harduerit, ruajtjen dhe procesimin e të dhënave dhe sigurisë kibernetike për QDhSh-në. Poashtu, investimet janë orientuar për ofrimin e shërbimeve të TI-së për institucionet publike, në zhvillimin e sistemeve të softuerit, zhvillim të sistemit për ndërveprim të sistemeve elektronike të Qeverisë së Kosovës, zhvillim të e-shërbimeve për qytetarët dhe bizneset, marrje të shërbimeve si dhe trajnime të stafit për ngritje të kapaciteteve profesionale. Investimet më të mëdha janë realizuar gjatë periudhës 2018-2020, siç shihet edhe në grafikë dhe vlera e investimeve ishte mbi 16 milion euro.




Grafiku 1. Investimet e AShI-së në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit gjatë periudhës 2014 – 2022

⁹ Raport nga Drejtorati i QDhSh, AShI.

¹⁰ Kontratat e lidhura për zhvillime dhe shërbime/mirëmbajtje janë në periudhë tri (3) vjeçare, ku kontratat e lidhura të vitit 2021/2022 kanë zbatim deri në vitin 2023/2025. Ky raport është marr nga AShI-ja meqë divizioni i prokurimit MPB nuk ka arritur të na siguroj raportin e plotë nga themelimi i AShI-së.

Gjatë periudhës 2014-2022 shpenzimet më të mëdha janë bërë për blerjen e licencave të Microsoft me 52% dhe në sigurinë kibernetikë me 31%, të cilat janë të paraqitura në grafikun më poshtë.

VLERA E INVESTIMEVE NË TIK



Grafiku 2. Investimet e ASH-së në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në vlerë dhe përqindje

2. Objektivi dhe fushat e auditimit

Objektiv i auditimit është të vlerësohet se si AShI-ja i menaxhon projektet e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe sa është efektive në vlerësimin e projektit përfshirë procesin e inicimit, planifikimit, zbatimit dhe monitorimit.

Me këtë auditim synojmë që të ofrojmë rekomandime relevante për AShI-në, në mënyrë që të përmirësohet menaxhimi i projekteve në fushën e TIK-ut, pa përfshirë procesin e vlerësimit të ofertave përmes prokurimit.

Fushat e auditimit, për t'iu përgjigjur objektivit të auditimit, jemi fokusuar në fushën e qeverisjes të TI-së, zhvillimit dhe blerjes përfshirë edhe çështjet si në vijim:

Fushat e auditimit	Çështjet e auditimit
1. Qeverisja e TI-së	1. Identifikimi, Drejtimi dhe Monitorimi i kërkesave të biznesit
	2. Menaxhimi i rrezikut
2. Zhvillimi dhe Blerja	3. Zhvillimi dhe menaxhimi i kërkesave
	4. Menaxhimi dhe Kontrolli i projektit
	5. Menaxhimi i konfigurimit
	6. Siguria

Fokus i auditimit ka qenë planifikimi, menaxhimi dhe monitorimi i projekteve për sistemet e TIK-ut. Auditimi ka mbuluar periudhën e vitit 2019 deri në vitin 2022, pa e kufizuar fushëveprimin për kontratat aktive të lidhura para kësaj periudhe. Fokusi i auditimit është bazuar në nivelin e shpenzimeve dhe rreziqeve të identifikuara gjatë kësaj periudhe, si dhe kërkesa e bërë për auditim nga MPB-ja. Metodologjia e auditimit dhe kriteret gjenden në shtojcën e këtij raporti¹¹. Fushëveprimi i këtij auditimi është Agjencia e Shoqërisë së Informacionit.

¹¹ Shtojca 1, kriteret e auditimit dhe metodologjia e auditimit

3. Gjetjet e auditimit

Në këtë kapitull janë paraqitur gjetjet e auditimit që kanë të bëjnë me aktivitetet e palëve përgjegjëse për menaxhimin e projekteve të TI-së gjatë procesit të identifikimit, planifikimit dhe monitorimit të projekteve, për zhvillimin dhe zbatimin e sistemeve të informacionit. Janë audituar 12 kontrata¹² me vlerë totale rreth 16 milion euro. Gjetjet janë të strukturuar sipas çështjeve të auditimit.




Figura.2 Struktura e çështjeve të auditimit në ASH

1. Mangësi në identifikimin dhe menaxhimin e kërkesave për projekte të TI-së

ASH-ja duhet të ketë një plan sesi të identifikojë kërkesat e reja të biznesit ose nevojat e TI-së dhe Komiteti Drejtues/Menaxhmenti, i cili aprovon kërkesat, duhet të ketë informacion të mjaftueshëm për vendimmarrje.¹³ Komisioni për vlerësimin e projekteve ideore të TIK-ut në kuadër të ASH-së duhet t'i trajtoj projektet e të gjitha IRK-ve.¹⁴

ASH-ja nuk ka një proces të strukturuar për identifikimin e kërkesave të reja dhe nevojave të TI-së. Nuk propozon një plan të mirëfilltë për menaxhmentin, ku duhet të përfshihen qartë detajet për nevojat e TI-së si dhe mundësitë dhe propozimi për zgjidhjen konkrete dhe efikase për secilën nga këto kërkesa.

Kërkesat në ASH paraqiten nga zyrtarët përkatës të fushës për sektorin dhe departamentin përkatës të Agjencisë. Bëhen analiza në kuadër sektori, pastaj kërkesat kalojnë në nivel departamenti dhe propozohen më tej për t'u vendosur në kornizën afatmesme të shpenzimeve (KASH) dhe në ligjin e buxhetit. Pas miratimit të ligjit të buxhetit bëhet/propozohet plani i

¹² Lista e kontratave të audituara gjendet në Shtojcën II.

¹³ Manuali i auditimit të Teknologjisë së Informacionit, matrica e auditimit mbi Qeverisjen e TI-së.

¹⁴ Rregullore (QRK) nr. 06/2018 për menaxhimin e projekteve në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, është miratuar në mbledhjen e 39 të - Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendim Nr.04/39 me datë 04.04.2018

prokurimit dhe dërgohet të zyra e prokurimit në MPB për zbatimin e projekteve sipas buxhetit të miratuar.

Megjithatë, gjatë auditimit kemi vërejtur se ASHl-ja nuk e ka organizuar mirë këtë proces, ka mangësi në arsyetimin e projekteve dhe prioritizimin e tyre, identifikimin e kërkesave si dhe vlerësimin e projekteve për IRK-të.

- Në planin e prokurimit të propozuar nga ASHl-ja, projektet nuk arsyetohen si duhet në mënyrë që Ministria të ketë informacione të mjaftueshme për vendosjen e projekteve të reja në plan. Po ashtu, nuk ka komunikim të mirë në procesin e vendosjes së projekteve në planin final të prokurimit. Ka raste kur projektet që konsiderohen me prioritet nuk janë vendosë në planin final të prokurimit, por janë proceduar projekte me pak prioritare Si në rastin për blerje të licencës për menaxhimin e “Active Directory” (AD)¹⁵. Ky sistem aktualisht nuk shfrytëzohet shumë sepse menaxhimi i AD realizohet me shumë me konzolë të “Domain Controller-it”¹⁶. Sipas ASHl-së, produktin për menaxhimin e AD e kishin përfituar nëpërmjet donatorit dhe ideja e këtij projekti ka qenë që ky sistem të ndërlihdet me sistemin për menaxhimin e burimeve njerëzore (SIMBNj). Por SIMBNj është pa mirëmbajtje dhe nuk është realizuar ndërlihdja me këtë sistem.
- ASHl-ja nuk bën koordinimin e mirëfilltë të kërkesave dhe projekteve me organizatat tjera. Në buxhetin e Agjencisë për investime janë përfshirë disa projekte që kanë të bëjnë me organizatat tjera e të cilat nuk janë realizuar. Në Planin e Prokurimit gjatë viteve 2019-2021 ishte planifikuar blerja e softuerit/licenca softuerike Archicad, GIS¹⁷, “Zhvillimi i SISH¹⁸-cyber security” dhe “Krijimi i sistemit PAKS¹⁹ Radiologji” për infrastrukturë harduerike. Mirëpo ASHl-ja nuk ka marrë veprime të mjaftueshme për koordinimin dhe zbatimin e këtyre projekteve. Përveç projektit “Krijimi i sistemit PAKS” që janë zhvilluar procedurat por nuk është lidhur kontrata në mungesë të buxhetit të mjaftueshëm, për projektet tjera nuk janë zhvilluar procedurat për realizim. Gjatë vitit 2019 dhe 2020 projektet e zbatuara nga Agjencia, nuk kishin plan ideor të projektit. Plani ideor duhet të trajtohet nga komisioni për vlerësimin e projekteve të TIK-ut në aspekt të dyfishimit të projektit, kostos, etj., dhe pas trajtimit të marr pëlqimin për inicim të projektit. Kjo procedurë duhet të kryhet para se projekti të përfshihet në planin e prokurimit. Ndërkohë, Agjencia ka filluar trajtimin e projekteve ideore të saj, megjithatë gjatë vitit 2021 dhe 2022, nuk është bërë plani ideor i të gjitha projekteve të TI-së në ASHl për t’u trajtuar nga komisioni sipas rregullores.

¹⁵ Active Directori, është shërbim i Microsoft, për autorizimin dhe autentifikimin e përdoruesve dhe pajisjeve të TI-së në domenin e rrjetit të organizatës

¹⁶ Domain Controller është një server që përdoret në një rrjet kompjuterik me sistemin operativ Windows Server për të menaxhuar dhe kontrolluar identitetet dhe të drejtat e hyrjes për përdoruesit dhe pajisjet e rrjetit.

¹⁷ Geographic Information System (Sistemi Informativ Gjeografik).

¹⁸ Sistemi Informativ Shëndetësor.

¹⁹ Picture archiving and communication system- Sistemi i Arkivimit dhe Komunikimit të Imazheve

Mungesa e një procesi të strukturuar në ASHI për identifikimin, aprovimin dhe koordinimin e kërkesave, ka ndikuar që projektet me prioritet të mos realizohen dhe përfshihen në planin e prokurimit. Kjo ndikon negativisht në arritjen e objektivave të Agjencisë dhe të institucioneve, por edhe në orientimin e fondeve publike për projekte jo efektive.

2. ASHI-ja ka mangësi në hartimin e planit për menaxhimin e rreziqeve të TI-së

Organizata duhet të ketë politika dhe plane të menaxhimit të rrezikut, si dhe të përcaktoj burimet e mjaftueshme për të identifikuar dhe menaxhuar rreziqet.²⁰

ASHI-ja nuk ka një politikë për të menaxhuar rreziqet e TI-së, duke përfshirë identifikimin, vlerësimin, trajtimin, monitorimin dhe raportimin e tyre. Një plan i menaxhimit të rreziqeve hartohet çdo vit në nivel të Ministrisë (MPB) edhe ASHI është pjesë e këtij plani. Mirëpo, ky plan është i përgjithshëm dhe nuk përfshin rreziqet specifike të sigurisë së informacionit, të cilat mund të shkaktojnë humbje të të dhënave, ndërprerje të shërbimeve dhe dëme financiare për Agjencinë. Në qershor të vitit 2022, ASHI-ja hartoi një plan të menaxhimit të rreziqeve me kërkesë të Ministrit, por pa një analizë të mirë të gjendjes dhe nuk parashikonte veprime të qarta dhe specifike për parandalimin dhe trajtimin e rreziqeve. Për më tepër plani nuk është rishikuar në fund të vitit për të vlerësuar nëse investimet e bëra kanë ulur rrezikun ose ka rreziqe të reja që duhet të adresohen.

ASHI-ja ende nuk ka arritur të ndërtojë qendër të rimëkëmbjes nga fatkeqësitë, për shkak të mungesës së përcaktimit të zonës nga MPB-ja. Mungesa e qendrës me standarde për siguri të informacionit vlerësohet me rrezik shumë të lartë, megjithatë, në raportet e menaxhimit të rrezikut, ASHI-ja e ka vlerësuar rrezikun në nivel të mesëm.

Po ashtu, politika e vjetër për sigurinë e informacionit është shfuqizuar dhe ASHI-ja ende nuk ka një politikë të re, si dhe nuk është përcaktuar cilin standard për siguri të informacionit duhet të zbatojnë. Gjithashtu, në ciklin e zhvillimit të projekteve të TI-së ASHI-ja nuk ka bërë prioritizimin e projekteve sipas rrezikut për arritjen e objektivave të organizatës. Si pasojë, në shtator të vitit 2022 ASHI-ja u detyrua të ndërpresë shërbimet për një periudhë kohore. Si zgjidhje emergjente, ata ishin të detyruar të lidhnin kontratë për blerjen e shërbimit me internet për siguri kibernetike, në një procedurë të negociuar me afat kohorë të përsheptuar, pa qenë si projekt në planin e prokurimit.

Në mungesë të një plani të detajuar për menaxhimin e rrezikut në TI, ASHI-ja rrezikon të përballet me probleme serioze në sigurinë e të dhënave. Kjo situatë mund të rezultojë në humbje të të dhënave të rëndësishme, ndërprerje të shërbimeve dhe dëme financiare për institucionin.

3. ASHI nuk ka menaxhuar mirë investimet në projektet e TI-së

Organizatata duhet të menaxhojnë projektet dhe investimet e tyre të TI-së, me qëllim të maksimizimit të përfitimeve dhe konsiderimin e elementëve, të tillë si rrezikun, kapacitetet, dhe prioritarizimi në mes investimeve konkurruese.²¹ Organizata duhet të përllogaritë vlerën e parashikuar për një kontratë publike para inicimit të procedurës së prokurimit. Paralogaritja e tillë duhet të jetë e arsyeshme dhe

²⁰ Manuali i auditimit të Teknologjisë së Informacionit, matrica e auditimit mbi Qeverisjen e TI-së.

²¹ Manuali i auditimit të Teknologjisë së Informacionit, matrica e auditimit mbi Qeverisjen e TI-së.

reale për kontratën e parashikuar nga aspekti i efikasitetit, efektivitetit të kostos dhe përdorimit transparent dhe të drejtë të fondeve dhe resurseve publike.²² Organizata duhet të ketë një plan menaxhimi të projekteve ose ekuivalent me të për çdo projekt të aprovuar, i cili udhëzon ekzekutimin e projektit.



Figura 3. Cikli e menaxhimit të projektit

ASHI-ja nuk zbaton një plan/metodologji të standardizuar për menaxhimin e projekteve për blerjen e pajisjeve harduerike, përmirësimin e sistemeve ekzistuese ose zhvillimin e sistemeve të reja, ndërlydhjen e sistemeve, etj. Nuk ka raporte të analizave të kost-benefitit për projektet para se të aprovohen për zhvillim. Për më tepër, nuk ka bërë monitorim të zbatimit të projekteve për një shfrytëzim më efektiv të investimeve. Si pasojë gjatë zhvillimit të projekteve janë identifikuar disa mangësi si në vijim:

Menaxhimi i projektit “Portali i shërbimeve e-Kosova”

Projekti “Portali i shërbimeve e-Kosova” (tutje e-Kosova), është portal i shërbimeve elektronike, i cili ka për objektive që nëpërmjet një dritare të vetme çdo qytetar/biznes mund të marrë nëpërmjet internetit një numër të konsiderueshëm të shërbimeve elektronike që ofrohen nga institucionet publike në Kosovë. Zhvillimi i kësaj platforme ka filluar gjatë periudhës së pandemisë “Covid 19” dhe kontrata ka përfunduar në dhjetor 2022.

- Në kohën e inicimit²³ për zhvillimin e projektit “e-Kosova”, ASHI-ja nuk ka bërë analizë të fizibilitetit për gjendjen aktuale të sistemeve të informacionit të IRK-ve, për të vlerësuar mundësinë e zhvillimit të e-shërbimeve në këtë platformë. Për zhvillimin e këtij projekti ASHI-ja është mbështetur në “Raportin për Studimin e Fizibilitetit për e-qeverisjen dhe investimet në TI”²⁴ i hartuar në maj të vitit 2016 dhe në Strategjinë për Modernizimin e Administratës Publike 2015-2020.

²² Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës dhe Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik.

²³ Prill 2019

²⁴ Në këtë raport ishte prezantuar analiza e nevojave të Qeverisë së Kosovës për sa i përket TIK-ut në njërin anë dhe praktikave më të mira ndërkombëtare në anën tjetër, dhjetë projekte me prioritet në institucionet qeveritare të identifikuar dhe vlerësuara për sa i përket digjitalizimit dhe interoperabilitetit të tyre (teknikisht dhe financiarisht).

Si rrjedhë, në mungesë të informatave të detajuara se cilat e-shërbime do të zhvillohen në platformë, në inicimin e këtij projekti për prokurim kanë përcaktuar zhvillimin e e-shërbimeve sipas kategorisë, pa specifikuar në detaje cilat e-shërbime do të zhvillohen.

- Ndërsa në procesin e përcaktimit të vlerës së parashikuar të kontratës për zhvillimin e platformës e-Kosova, ASHI-ja ka angazhuar ekspert për hartimin e specifikimit teknik të kësaj platforme. Eksperti kishte përllogaritur se kosto për zhvillimin e platformës me modulet e saj, e cila përfshinë zhvillimin kryesor të platformës softuerike mund të arrijë 1.1 milion euro. Ndërsa, për e-shërbimet që do të zhvillohen nuk ka dhënë çmim, me arsyetimin që nuk ka njohuri për kompleksitetin e shërbimeve që do të përcaktohen për zhvillim. Kjo ka ndikuar që angazhimi i ekspertit të mos arrijë qëllimin e synuar.

Por, ASHI-ja kishte rritur vlerën e parashikuar për këtë kontratë edhe për 2.2 milion euro tjera, duke e përcaktuar vlerën e përafërt prej 3.3 milion euro. Kjo është bërë pa specifikuar qartë numrin e shërbimeve që do të zhvillohen për tri vite dhe kompleksitetin e tyre. Kjo, me arsyetimin se nuk kanë përvojë në zhvillime të këtij lloji projekti, duke pasur parasysh edhe ndryshimet ligjore, prioritetet e institucioneve për digjitalizimin e shërbimeve. Si bazë për përcaktimin e çmimit ka marrë çmimet e platformave tjera shtetërore në rajon.

Por me rastin e ofertimit për zhvillimin e e-shërbimeve, njëri nga OE-të ka dhënë propozimin se cilat e-shërbime do të zhvillohen në kuadër të kontratës gjatë tri viteve. Në procesin përzgjedhës ky OE është shpallur më i suksesshëm/fitues nga ASHI-ja duke lidhur kontratë në vlerë prej 2,976,509 euro për realizimin e kësaj platforme.

- Në inicimin e projektit “e-Kosova”, ASHI-ja në fazën e pilotimit prej 2.5 muaj²⁵ i ka dhënë prioritet zhvillimit të e-shërbimeve për këto sisteme kryesore:
 - Sistemi i Gjendjes Civile;
 - Sistemi i Regjistrimit të Bizneseve;
 - Sistemi i Regjistrimit të OJQ-ve (Organizatave Jo Qeveritare);
 - Sistemi i Letërnjoftimeve;
 - Sistemi i Regjistrimit të Automjeteve; dhe
 - Sistemi i Skemave Sociale.

Këto prioritet janë përcaktuar pa u koordinuar me institucionet të cilat kanë në pronësi këto sisteme për tu siguruar se kanë bazë ligjore për ndërlikime, mirëmbajtje të sistemeve, si dhe kanë gatishmërinë dhe kapacitetet të zhvillojnë ueb shërbimet në ato sisteme që të mundësohet marrja apo dhënia e të dhënave nëpërmjet platformës. Si rezultat, asnjëra nga këto gjashtë sisteme nuk ka arritur të ndërlikohet në platformën e-Kosova brenda kësaj periudhe.

Për më tepër Sistemi i Regjistrimit të Bizneseve, Sistemi i Letërnjoftimeve, Sistemi i Regjistrimit të OJQ-ve dhe Sistemi i Skemave Sociale, nuk janë intergruar ende në

²⁵ Faza fillestare dhe faza e zhvillimit kanë qenë të parapara të realizohen për periudhë 5.5 muaj.

platformë, as brenda periudhës tri (3) vjeçare të kontratës e-Kosova, për shkaqe të mosgatishmërisë të institucioneve fundore dhe aspekteve ligjore.

- Ndërkohë gjatë periudhës së zhvillimit të këtij projekti, Qeveria ka kërkuar zhvillimin e e-shërbimeve sipas nevojave të tyre, të cilat janë zbatuar në platformën e-Kosova. Për këtë arsye ASH-I-ja ekuivalentoi/zëvendësoi disa prej këtyre shërbimeve të kërkuara nga Qeveria me shërbime të cilat nuk mund të zhvilloheshin sipas kontratës. Por në raportin e menaxhimit të kontratës nuk është definuar cili shërbim është ekuivalentuar me shërbimin i cili nuk ka pas mundësi të zhvillohet gjatë periudhës kontraktuese të zhvillimit të projektit.

Grupi teknik në ASH-I, me 20 dhjetor 2022, me përfundim të kontratës, ka përgatitur raport lidhur me shërbimet të cilat janë ekuivalentuar me ato kategori të shërbimeve të cilat nuk janë zhvilluar. Raporti është bazuar dhe referuar në shkresat e OE-së për ekuivalentimin e shërbimeve. Megjithatë raporti nuk përmban analizë të qartë të kompleksitetit të shërbimeve të ekuivalentuara. Sipas raportit në tri kategoritë e pazhvilluara për krijimin e shërbimeve: lidhur me **proceset doganore, regjistrimin e bizneseve dhe pasaportave**, janë ekuivalentuar disa shërbime që i takojnë/ndërlidhen me kategoritë e shërbimeve për regjistrimin e automjeteve dhe shërbimeve lidhur me edukim dhe arsimim, etj. Por shërbimet e kategorisë për automjete dhe edukim e arsim ishin parashikuar dhe zhvilluar si kategori të veçanta në kuadër të kësaj kontrate dhe ishin paguar.

Kostoja e krijimit të një kategorie të e-shërbimeve sipas kontratës ishte 42,421 euro dhe ASH-I-ja për tri kategoritë e pa zhvilluara sipas kontratës të cilat janë ekuivalentuar me shërbime tjera ka paguar 127,263 euro.

Gjithashtu, për kategorinë “Krijimi i shërbimeve për patentë shofer”, janë zhvilluar vetëm dy shërbime dhe është realizuar pagesa në vlerë 42,421 euro. Për më tepër këto shërbime ende nuk janë lansuar në platformën e-Kosova. Arsyeja është se institucioni fundor, përkatësisht Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës janë në proces të përgatitjes teknike për të zgjedhur operatorin që do të mirëmbajë platformën e-Testimit.

ASH-I-ja nuk ka bërë analiza lidhur me këto ndryshime dhe ekuivalentime të shërbimeve me qëllim të shfrytëzimit efikas të kontratës, duke marr parasysh edhe faktin se në kontratën e projektit e-Kosova ishte parashikuar krijimi i tre sistemeve/e-shërbimeve të reja sipas nevojave të bizneseve dhe qytetarëve. Në anën tjetër, kontrata ishte publike kornizë me mundësinë për shfrytëzim të +/- 30% të vlerës. Megjithatë ASH-I-ja për këtë kontratë realizoi porosinë e plotë dhe ka paguar vlerën totale të kontratës²⁶, edhe pse jo të gjitha shërbimet e planifikuara ishin zhvilluar ndërsa nuk është analizuar/nxjerrë kosto për shërbimet e ekuivalentuara.

- Gjatë zhvillimit të e-shërbimeve në projektin “e-Kosova”, në dosjen e tenderit kërkohej që të gjitha shërbimet të ndërlidheshin me GG platformën. Aktualisht nëpërmjet GG

²⁶ Përveç kategorisë Krijimi i shërbimeve për regjistrimin e OJQ, vlera 42,421euro.

platformës shfrytëzohen 9 shërbime për ndërlidhje në platformën e-Kosova. Në projektin e-Kosova janë realizuar shërbime të cilat janë ndërlidhur drejtpërdrejt me sistemin burimor, me arsyen që gjatë zhvillimit të e-shërbimeve në platformën e-Kosova, për GG platformën nuk ka pas mirëmbajtje që të zhvillohen shërbimet e nevojshme. Andaj, kjo mund të ndikon në sigurinë e informacionit dhe në kosto shtesë.

- Në kuadër të projektit e-Kosova, ASHI-ja po ashtu ka përfshirë realizimin e një kampanjë mediale dhe të marketingut. Kjo kampanjë është përfshirë pa përcaktuar planin dhe fushëveprimin për aktivitetet që duhet të ndërmerren në funksion të projektit e-Kosova, apo objektivave që duhet të arrihen me këtë kampanjë. Kjo është realizuar në bazë të ofertës/propozimit që ka bërë OE-ja. ASHI-ja ka pranuar ofertën për marketing e cila kishte kosto prej 86,694 euro, e cila është paguar në kuadër të projektit.

Platforma e-Kosova është në funksion dhe shfrytëzohet nga qytetarët. Megjithatë, në mungesë të analizës së mjaftueshme për identifikimin e nevojave për zhvillimin e platformës me modulet/sistemet e saj dhe zhvillimin e e-shërbimeve, mungesës të komunikimit me palët e interesit të IRK-ve, lëvizjeve të stafit, ASHI-ja nuk ka arritur të realizoj projektin në kohë dhe sipas planit. Po ashtu, në mungesë të menaxhimit të duhur të kontratës dhe analizës së detajuar për ekuivalentimin dhe kompleksitetin e shërbimeve, nuk është arritur shfrytëzimi ekonomik dhe efikas i kontratës, duke mos e shfrytëzuar as mundësinë e kontratës kornizë, por është paguar plotësisht vlera e kontratës.

Menaxhimi i projektit “Licenca Microsoft për universitete dhe shkolla”

- Në inicimin e projektit për blerjen e licencave të Microsoft për edukim në universitete dhe shkolla, ASHI-ja nuk ka bërë një analizë të mirë për përcaktimin e blerjes së licencave për shkolla dhe aktivizimin e tyre. Në mars të vitit 2015, MASHT, MAP dhe Microsoft kishin nënshkruar një memorandum bashkëpunimi për përdorimin e licencave të Microsoftit në sistemin e arsimit parauniversitar, për periudhën mars 2015 deri në qershor 2018. Në kuadër të këtij memorandumit përfshihen programe të ndryshme dhe Microsoft Office 365 ofrohet falas për arsim. Në dhjetor të vitit 2017, ASHI-ja zhvilloi projektin për blerjen e licencave të Microsoft për edukim dhe nënshkroi një kontratë kornizë me OE-në për periudhën janar 2018 deri dhjetor 2020, për furnizim me licenca.
- Projekti (procedurat e prokurimit), për blerjen e licencave të Microsoft për edukim në arsimin parauniversitar është iniciuar nga ASHI-ja më 23.06.2017. Kërkesa për pajisje me licenca ishte bërë nga MASHT fillimisht me 13.06.2017. Mirëpo, me 28.06.2017 ASHI-ja ka pranuar kërkesën e dytë nga MASHT të ndryshuar me numrin e licencave (me numër më të vogël të licencave), ashtu siç ishte në kërkesën inicuese të ASHI-së për llojin dhe numrin e licencave. Në këtë kërkesë MASHT-i kishte kërkuar ndihmë dhe mbështetje nga ASHI-ja dhe OE-ja për planifikimin dhe instalimin e këtyre produkteve nëpër shkolla, për shkak se nuk kishte departament adekuat të TI-së për shkolla/pedagogjike. Në periudhën 2018-2020, MASHT kishte shfrytëzuar çdo vit 5611 licenca të Windows Education dhe Office 365 që ishte në harmoni me sasinë e planifikuar/porositur. Produktin Microsoft Imagine Academy për trajnimin e mësimdhënësve ASHI-ja dhe OE-ja kishin aktivizuar vetëm një

(1) licencë çdo vit nga 8 sa ishin të planifikuara/porositura në vit. Ndërsa, produkti Office Professional Plus nuk është shfrytëzuar. Për kategorinë e arsimit para-universitar, kërkesa për sasinë e licencave dhe shfrytëzimin e tyre është specifikuar në tabelë.

Licencat e Microsoft-it për Shkolla 2018-2020					
Nr.	Emërtimi	Sasia për 3 vite	Sasia e shfrytëzuar për 3 vite	Çmimi për njësinë euro	Çmimi me TVSH në euro
1	Office Professional Plus	15000	0	26.76	401,400
2	Windows Education	16833	16833	23.42	394,229
3	Microsoft® Office 365	16833	16833	26.76	450,451
4	Microsoft® MS Imagine Academy	24	3	1,884.42	45,226

Tabela 2. Lista e licencave të Microsoft për arsimin parauniversitar të porositura dhe shfrytëzuara gjatë periudhës 2018-2020

- ASH-ja kishte porositur llojin dhe numrin e njëjtë të licencave për shkolla çdo vit me kërkesë të MASHT-it, por disa nga ato nuk ishin aktivizuar. Ndërsa në porosinë për vitin 2020, MASHT-i kishte përjashtuar (zvogëluar) nga kërkesa licencat “Office Professional Plus” dhe për licencën “Microsoft® MS Imagine Academy” kishte kërkuar vetëm një (1) licencë për vit, për shkak se këto licenca nuk ishin shfrytëzuar/aktivizuar në shkolla. Mirëpo, ASH-ja ka kërkuar nga MASHT-i të vlerësoj nevojën e rishikimit të porosisë bazuar në kushtet e kontratës. Para nënshkrimit të kontratës në mes të ASH-së dhe OE-së, ASH-ja dhe Microsoft në tetor 2017 kanë bërë marrëveshje ku ishte e përcaktuar porosia minimale e licencave për edukim. Pas rishikimit është rritur numri i licencave në kërkesë dhe janë marr zotime nga ASH, MASHT, OE-ja dhe Microsoft për zbatimin e aktiviteteve, përfshirë aktivizimin e licencave. Mirëpo, për këto licenca nuk kishte dëshmi që janë aktivizuar. Andaj nga menaxhimi jo i mirë i kontratës nga palët përgjegjëse të projektit, janë realizuar porosi për licenca të cilat nuk janë shfrytëzuar dhe kishin krijuar shpenzime në vlerën 440,973 euro²⁷. Rrjedhimisht janë shkaktuar dëme financiare për licencat e porositura dhe të pa aktivizuara për shkolla për periudhën 2018-2020. Ndërsa lidhur me këtë projekt janë shfrytëzuar licenca në vlerë prej 850 mijë euro. Në total shpenzimet/pagesat për projektin Licenca Microsoft për shkolla janë 1,291,306 euro.
- Për më tepër për numrin e licencave për universitete, ASH-ja ka bërë porosi sipas kërkesës së OE-së dhe jo sipas nevojës së tyre. Me 11 dhjetor 2019 ASH-ja kishte bërë porosi te OE-ja për llojin dhe numrin e licencave të Microsoft-it, për shfrytëzim të tyre gjatë vitit 2020. Me pas OE-ja kishte kërkuar të rritet numri i porosive me arsyen që ai ka bërë porosinë të nënkontraktuesi dhe ndryshimi në vlerë nga porositë paraprake të vitit 2018 dhe 2019 ishte

²⁷ Ndërsa vetëm në periudhën 2019-2020, për licenca të pashfrytëzuara ASH-ja ka shpenzuar 293,982euro.

rreth 65 mijë euro²⁸. ASHI-ja ka zbatuar kërkesën e OE-së dhe me 19 dhjetor 2019 ka bërë kërkesën e re, duke rritur numrin e licencave. Kontrata e lidhur për këtë shërbim ishte kontratë kornizë me mundësi shfrytëzimi +/- 30%, megjithatë kjo nuk ishte shfrytëzuar nga ASHI-ja. Vlera e kontratës për tri vite ishte 1,945,196 euro e cila ishte shfrytëzuar mbi 90% dhe në total për tri vite janë paguar 1,995,727 euro²⁹.

Shpenzimet në vlerë prej 505,973 euro³⁰ përbëjnë 26% të vlerës totale të kontratës për projektin "Licenca Microsoft për universitete dhe shkolla", për këtë vlerë nuk është bërë përfitimi, andaj mund të ishte kursim në këtë projekt³¹.

Mangësitë në menaxhimin joadekuat të kësaj kontrate burojnë nga çështje të ndryshme gjatë gjithë procesit, duke filluar nga analiza e nevojave për blerje të licencave e deri te shpërndarja dhe aktivizimi i tyre. Gjithashtu, mosshfrytëzimi i përfitimeve të mundshme në kuadër të kontratës +/- 30% dhe zbatimi i kërkesës së OE për rritjen e porosisë, ka rezultuar që ASHI-ja të bëjë porosi të licencave të cilat nuk janë shfrytëzuar, duke sjellë dëme financiare.

Menaxhimi i projektit "Licenca Microsoft për IRK-të"

- Për projektin e licencave të Microsoft për periudhën 2018-2020, ASHI-ja nuk ka kryer monitorim të duhur gjatë zbatimit të kontratës. Pra, nuk kanë monitoruar përdorimin dhe nevojat e licencave në institucione para se të bëhet porosia vjetore licencave për të parë nëse ato ishin të nevojshme për institucionet. Po ashtu, nuk kanë raporte të sakta të shpërndarjes dhe shfrytëzimit të licencave, për të vlerësuar nevojën për porosi të reja për vitin pasardhës.
- Po ashtu, për përkrahje teknike për produktet dhe zgjidhjet e Microsoft, ASHI-ja ka porositur 200 orë në vit për periudhën 2018-2020. Ndërsa ASHI-ja nuk ka dokumentacion që dëshmon se kjo përkrahje është marrë nga Microsoft. Agjencia ka paguar OE-në 28,320 euro në vit për përkrahje teknike nga Microsoft pa dëshmuar se ka pranuar/marr shërbimin. Në total për dy vite ka paguar 56,640 euro.

Mos identifikimi i mirë i nevojave për licenca në IRK dhe përkrahje teknike, si dhe mungesa e monitorimit të vazhdueshëm për shpërndarjen e tyre dhe marrjen e shërbimit, ndikon që të bëjnë porosi të panevojshme për licenca dhe shpenzim të panevojshëm të buxhetit për shërbime.

²⁸ Vlera prej 65 mijë euro përbënë rreth 3.4% të vlerës së kontratës kornizë.

²⁹ Çmimi më i lartë i pagesës është për shkak të ndryshimit të valutë \$ gjatë viteve, meqë kompania Microsoft për tregun e Kosovës ofron çmime vetëm me USD.

³⁰ 440,973 euro për vitet 2018-2020 dhe 65,000 euro për porosinë e rritur.

³¹ Për periudhën 2019-2020 shpenzimet e panevojshme ishin 358,982 euro apo rreth 18% e vlerës së kontratës.

Menaxhimi i projektit “Licencat për Siguri kibernetike dhe monitorim”

- Në inicimin e blerjes së licencave softuerike për monitorim dhe siguri ASHl-ja kishte planifikuar blerje të sistemit për siguri të informacionit dhe menaxhimin e ngjarjeve (SIEM). Në specifikimin teknik kishte kërkuar që numri i grumbulluar i ngjarjeve në sekondë (EPS) nga pajisjet të jetë 20 mijë. Mirëpo, nuk kishte specifikuar në tërësi për cilat sisteme do t'i grumbullojnë ngjarjet/aktivitetet, në mënyrë që të vlerësohet numri i ngjarjeve të grumbulluara, si dhe pse duhet të jetë 20 mijë numri i ngjarjeve. Numri i ngjarjeve që duhet të grumbullohen në “SIEM” përcakton edhe çmimin vjetor për licencë. ASHl-ja këtë numër të ngjarjeve e ka përcaktuar në raport me buxhetin, sepse sa më i madh të jetë numri i ngjarjeve, çmimi është më i lartë. Agjencia ka lidhur kontratë për tri (3) vite në vlerë 134,095 euro për këtë shërbim por nuk ka arritur t'i konfigurujë të gjitha sistemet në SIEM.
- Në planin e menaxhimit të projektit “SIEM”, kemi identifikuar se pagesa vjetore e projektit është realizuar plotësisht, megjithëse jo të gjitha aktivitetet janë realizuar në afatin e parashikuar në planin dinamik të punës. Aktivitetet si trajnimi i stafit dhe dokumentimi teknik i konfigurimeve nuk janë realizuar brenda afatit të parashikuar. ASHl-ja ka pranuar vetëm raportin e punës, ndërsa trajnimi për këtë sistem është bërë me vonesë (pas 4 muajve) në mars të vitit 2023, për shkak të angazhimeve të stafit të ASHl-së. Kjo tregon se Plani i menaxhimit të kontratave është i mangët. Menaxhimi i kontratës bëhet sipas raporteve të punës nga palët e përfshira dhe nuk ka siguri nëse projekti është realizuar plotësisht ose jo.
- Po ashtu, në kuadër të projektit për licenca softuerike për monitorim dhe siguri, ASHl-ja kishte planifikuar të blejë licencë për auditimin e aktiviteteve në “Active Directory” (AD). Nga ana tjetër edhe nëpërmjet SIEM mund të bëhet auditimi i aktiviteteve në AD. Ky projekt ishte realizuar me arsyen se sistemi për auditimin e aktiviteteve në AD ka më shumë veçori në krahasim me SIEM dhe numri i ngjarjeve është i kufizuar. Për këtë sistem ASHl-ja nuk ka bërë hulumtim të tregut, përderisa ka pasur mundësi me lehtësi të informohet direkt në ueb faqen zyrtare të këtij produkti dhe të parashikojë vlerën e kontratës bazuar në hulumtim. Megjithatë ka zgjedhur të bazohet në çmimin e kontratës paraprake duke përcaktuar vlerën e parashikuar vjetore prej 15 mijë euro apo 45,000 euro për tri vite, e që është më i lartë se çmimi aktual i tregut për këtë produkt/shërbim. Pasi në ueb faqen zyrtare të këtij produkti, kemi vërejtur se në vitin 2023 çmimi i licencës ishte rreth shtatë (7) mijë euro, (pa përfshirë taksat). Por, ASHl-ja për këtë produkt ka lidhur kontratë në vlerë 54,075 euro për tri vite, duke e tejkalluar edhe vlerën e parashikuar.

Mosidentifikimi i nevojave për regjistrimin e ngjarjeve në sistemet e informacionit dhe moskonfigurimi i të gjitha sistemeve në SIEM, mund të çojë në mungesë të regjistrimit të ngjarjeve për aktivitetet e ndryshme që realizohen në sistemet e informacionit. Kjo mund të rrezikojë identifikimin e aktiviteteve të qëllimshme apo aksidentale që mund të kenë ndikim

në cenueshmërinë e sistemit. Gjithashtu, mungesa e analizës së vlerës së parashikuar për blerje të licencës ka ndikuar në lidhje të kontratës me vlerë më të madhe se sa vlera e tregut.

Menaxhimi i projektit “Mirëmbajtja dhe servisimi i pajisjeve për TI në QShDh-ASHI”

- ASHI-ja kishte lidhur një kontratë kornizë tre (3) vjeçare (dhjetor 2019 - nëntor 2022) për mirëmbajtjen e gjithsej pesë (5) pajisjeve. Mirëmbajtja ishte mujore dhe faturohej 3,277 euro për muaj për pesë produktet si tërësi. Gjatë auditimit dhe intervistës me zyrtarët e ASHI-së kemi vërejtur se nga shtatori 2022 njëri nga pesë produktet (i cili përmbante më pak komponente) është larguar nga funksioni dhe mirëmbajtja. Ndërsa fatura për mirëmbajtje ka mbetur dhe është paguar e njëjtë. Agjencia nuk e ka larguar nga fatura produktin, me arsyetimin që në kontratë nuk është bërë ndarja e produkteve/njësive për pajisje.

Mirëpo kontrata për këto pajisje ishte kornizë e cila lejon që deri 30% e vlerës së kontratës të mos realizohet sipas nevojës. Në këtë rast ASHI-ja ka paguar faturën e plotë, për këtë ka ndikuar edhe mos ndarja në njësi e komponentëve. Si rrjedhojë nuk është arritur shfrytëzimi i mundësisë së kontratës kornizë dhe për tre muaj njëra nga 5 pajisjet është faturuar dhe paguar pa nevojë. Për më tepër, gjatë analizimit të dëshmimeve të ofruara nga ASHI-ja për kohën e ndaljes së pajisjes, kemi vërejtur edhe ndalje të mëhershme që datojnë nga muaji gusht 2020, për shkak të ngritjes së temperaturës në dhomën e serverit.

- Gjithashtu, për këtë kontratë ASHI nuk ka arritur të parashikoj vlerën e përafërt të çmimit, pasi që ka paraparë një vlerë 80,000 euro për vit, për 3 vite 240,000 euro. Ndërsa i është ofruar oferta me vlerë shumë më të ulët prej 117,967 euro me të cilën ka lidhur kontratë.

Planifikimi dhe monitorimi jo i mirë i menaxhimit të projektit, si dhe mungesa e specifikimit teknik të detajuar në kontratë dhe zberthimi në elemente për secilën komponentë me çmimin e saj, ka ndikuar të bëhen pagesa për shërbime që nuk janë kryer. Po ashtu, në mungesë të analizës për parashikimin e përafërt të çmimit, rrezikojnë që të lidhin kontrata me vlerë më të lartë se vlera e tregut, si dhe të mos shfrytëzojnë buxhetin në mënyrën të duhur për realizimin e projekteve tjera.

4. Mangësi në testet e pranimit të sistemit/shërbimeve në platformën e-Kosova

Vetëm ndryshimet e autorizuar dhe të aprovuara duhet të prezantohen në mjedisin e prodhimit (real).³² Menaxheri i kontratës duhet të sigurojë se OE-ja kryen kontratën në përputhje me termet dhe kushtet e specifikuara në kontratë. Përgjegjësi dhe detyrë e grupit teknik është pranim-dorëzimi i moduleve/shërbimeve të reja të integruara në portalin e-Kosova dhe testimi i funksionaliteteve të shërbimeve të ofruara nëpërmjet portalit.³³

Në kuadër të projektit e-Kosova ASHI-ja në dosjen e tenderit ka kërkuar sistem për ruajtjen e kopjes rezervë për platformën e-Kosova, i cili duhet ta ketë sistemin e kopjes rezervë dhe

³² Manuali i auditimit të Teknologjisë së Informacionit, matrica e auditimit mbi Zhvillimin dhe Blerjen.

³³ Vendim- Caktimi I menaxherit të kontratës dhe Grupi Teknik, më 25.09.2020.

restaurimit që mundëson vazhdimësinë efektive ose replikimin në kohë reale dhe ngritje automatike. Për më tepër ASHI-ja posedon një sistem të veçantë për ruajtjen dhe rikthimin e të dhënave.

Megjithatë, gjatë auditimit (vëzhgimit fizik), ASHI-ja nuk ka arritur të na prezantoj modulën/veglën për ruajtjen/rikthimin e të dhënave.

Sistemi që na është prezantuar nga ASHI-ja nuk kryente funksionet dhe nuk ishte i njëjtë me sistemin e kontraktuar dhe që figuronte i pranuar me dokumente të testit të pranimit të realizuar në shtator 2020.

Mirëpo, pas diskutimit të kësaj çështje me ASHI-në, në prill 2023 ASHI-ja ka dërguar dëshmi të veglës për ruajtjen dhe rikthimin e të dhënave të platformës e-Kosova. Nga dëshmitë e dërguara, vërehen funksionet e saj, mirëpo kjo vegël nuk ishte e integruar në platformën e-Kosova. Integrimi i kësaj vegle ishte realizuar pas përfundimit të kontratës. Për këtë vegël/sistem Agjencia ka paguar 219,415 euro në kuadër të projektit e-Kosova.

Po ashtu, ka raste ku pranimi teknik i shërbimeve nga grupi teknik është realizuar pas lansimit të shërbimeve, si dhe pranimi është realizuar vetëm nga një anëtar i grupit teknik. Mos pranimi teknik në kohë ishte me arsyetimin që testimet janë realizuar fillimisht nga institucionet fundore, të cilat kanë bërë kërkesë.

Mos testimi në kohë si dhe mos përfshirja e të gjithë anëtarëve të grupit teknik për testimin e pranueshmërisë së shërbimeve/moduleve, ka rezultuar në mos integrimin në kohë të veglës në platformë, si dhe anëtarët e grupit nuk kanë qenë në gjendje ta prezantojnë në kohë veglën e pranuar.

5. ASHI-ja nuk ka arritur të bëjë identifikimin e kërkesave për sistemet e TI-së lidhur me nivelin e klasifikimit të informacionit

Organizata duhet të ketë plane ose procedura sesi të mbledhë, të rishikojë dhe të kategorizojë kërkesat për funksionalitete të reja ose të shtuara.³⁴ Autoriteti i Klasifikimit, nga i cili informacioni i klasifikuar e ka origjinën, ka të drejtë të deklasifikoj informacionin atëherë kur nuk ka më nevojë për mbrojtje dhe nuk i përmbushë kriteret.³⁵

ASHI gjatë vitit 2022 ka lidhur dy kontrata me procedurë të hapur të prokurimit për vazhdimin e licencave të pajisjeve dhe mirëmbajtjen e pajisjeve. Këto dy kontrata të reja kanë qenë vazhdimësi e kontratës e lidhur në nëntor 2018 që sipas zyrtarëve të ASHI-së ishte e klasifikuar konfidenciale dhe përmbante shënjinin Dokument Konfidencial. Për këtë kontratë nuk është ofruar vendimi për nivelin e klasifikimit të informacionit³⁶. Andaj realizimi i këtyre dy kontratave është bërë pa e analizuar nivelin e klasifikimit dhe pa e deklasifikuar fillimisht informacionin nga kontrata konfidenciale.

Zyrtarët e ASHI nuk kanë ndonjë shpjegim të qartë për këtë me përjashtim të arsyetimit se kanë hezituar të bëjnë procedurë të negociuar dhe kanë ndjekur procedurën e hapur në

³⁴ Manuali i auditimit të Teknologjisë së Informacionit, matrica e auditimit mbi Zhvillimin dhe Blerjen.

³⁵ Ligji nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë

³⁶ Për arsye të klasifikimit, kjo kontratë nuk është audituar nga Zyra Kombëtare e Auditimit

mënyrë që mos të kufizojnë konkurrencën në mes të OE-ve me qëllim edhe të uljes së çmimit. Duke theksuar se një kontratë e tillë për licenca apo edhe ajo për mirëmbajtje nuk e rrezikon aspektin e sigurisë kibernetike.

Përveç që nuk kanë bërë një analizë të mirë të projekteve dhe nuk kanë respektuar legjislacionin në fuqi për klasifikimin e informacionit, po ashtu mund të rrezikohet shpалosja e informacionit konfidencial pa e ri-vlerësuar fillimisht dhe de-klasifikuar sipas legjislacionit.

6. Mangësi në prioritizimin e kërkesave të përdoruesve-IRK-ve

Organizata duhet të analizoj, prioritizoj dhe menaxhoj kërkesat për t'u siguruar se nevojat e përdoruesve janë plotësuar në mënyrë optimale dhe me kosto efektive.³⁷

Në procesin e inicimit të projektit të telefonisë "VOIP" dhe projektit "Siguria kibernetike në rrjeta", mungesa e përcaktimit të prioriteteve ka shkaktuar probleme në realizimin e tyre. Projektin "VOIP" e kanë filluar më herët se "Siguria kibernetike në rrjeta" për shkak të mungesës së stafit profesional dhe analizës së detajuar për përgatitjen e specifikimit teknik të projektit për siguri kibernetike në rrjeta.

ASHI-ja nuk ka një listë të nevojave të infrastrukturës së TI-së të IRK-ve dhe prioritizimit të tyre në QShDh për t'i ndihmuar në propozimin e ndarjes së buxhetit. Kërkesat e përdoruesve të IRK-ve zbatohen në varësi të nevojave që kanë dhe çka është e domosdoshme për atë fazë. Në rastet kur ASHI-ja nuk ka kapacitete për të realizuar zgjidhje, atëherë këto projekte mbetet të realizohen nga IRK-të, kjo për shkak të buxhetit të kufizuar të ASHI-së.

Po ashtu, ASHI-ja nuk i ka dhënë prioritet inicimit dhe realizimit të projektit për "Ngritjen e kapaciteteve harduerike" i planifikuar në planin e prokurimit për vitet 2019, 2020, 2021, i cili kishte buxhet të pamjaftueshëm. ASHI-ja në shtator/tetor 2021 kishte planifikuar fillimin e procedurave të prokurimit me një buxhet 10,000 euro, mirëpo vlera e parashikuar në inicimin e këtij projekti ishte rritur në 550 mijë euro, me arsyetimin se janë rritur kërkesat e IRK-ve lidhur me ruajtjen e kopjeve rezervë të sistemeve. Si pasojë, MPB-ja i ka ndërprerë procedurat e prokurimit me arsyetimin që nuk e kanë planifikuar buxhetin me kujdes dhe të mjaftueshëm. Kjo procedurë e prokurimit ka filluar në shtator të vitit 2022.

Mungesa e prioritizimit dhe arsyeshmërisë së projekteve të TI-së dhe ndarjes adekuate të buxhetit ndikon në vonesa të zbatimit të projekteve që ndikojnë negativisht edhe në projektet tjera që janë të ndërlidhura në mes veti, si dhe në menaxhim jo të mirë të buxhetit, duke rritur shpenzimet për këtë fushë në nivel vendi.

7. ASHI-ja ka vendosur në dosje të tenderit kërkesa që kufizon konkurrencën (diskriminuese)

Autoriteti kontraktues duhet që dosjen e tenderit ta përgatis në mënyrë që nuk kufizon konkurrencën në mesin e OE dhe/ose diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve.³⁸

Në dosjen e tenderit për projektin e-Kosova, ASHI-ja kishte vendosur kërkesë/kriter e cila ka kufizuar konkurrencën në procesin e përzgjedhjes së OE-së për realizimin e projektit. Kërkesa

³⁷ Manuali i auditimit të Teknologjisë së Informacionit, matrica e auditimit mbi Zhvillimin dhe Blerjen.

³⁸ Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës dhe Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik

ishte për ekspert kontrolle të cilësisë dhe auditimit të projektit. Kriteri për këtë ekspert ka qenë “të jetë i/e diplomuar në shkenca kompjuterike dhe/ose inxhinieri softuerike, me kualifikim prej jo më pak se PhD (Doctors of Philosophy)”. OE-të e interesuar për proces të prokurimit e kanë konsideruar diskriminuese këtë kërkesë dhe në “Pyetje sqaruese” gjatë procedurës së prokurimit, kanë kërkuar sqarime. Por ASHI-ja nuk ka dhënë përgjigje për të arsyetuar këtë kriter. Për përcaktimin/vendosjen e këtij kriteri ASHI-ja as gjatë auditimit nuk ka arritur ta argumentoj nevojën specifike të kualifikimit akademik/shkollor për këtë kuadër.

Si rezultat nga tre ofertuesit një operatorë ekonomik ka plotësuar këtë kriter përfshirë edhe kriteret tjera duke qenë në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit. dhe si i tillë është shpallur më i suksesshëm dhe fitues i kontratës.

8. ASHI-ja nuk zbaton plotësisht rregulloren për menaxhimin e projekteve të TI-së

Aktivitetet e menaxhimit të konfigurimit duhet të kryhen në pajtim me politikat ose procedurat organizative.³⁹Nga qershori i vitit 2018, të gjitha IRK-të janë të obliguara të zbatojnë rregulloren për menaxhimin e projekteve në fushën e TIK-ut, të cilat financohen nga buxheti i Kosovës dhe donacionet.⁴⁰

ASHI-ja nuk mban një regjistër të plotë të projekteve të saj të realizuara nga viti 2014 deri në 2022. Kemi identifikuar se ka pasur projekte të ASHI-së që nuk ishin përfshirë në regjistër apo listën e projekteve të ASHI-së. Gjatë auditimit, ASHI-ja mori veprime për të azhurnuar listën, por përmes këtij procesi u vështirësua gjetja e kontratave dhe nuk mund të garantohet se të gjitha projektet e realizuara janë përfshirë në regjistrin e projekteve.

Mosmirëmbajtja e regjistrit të projekteve të ASHI-së, rrezikon zhvillimin e projekteve të ngjashme dhe i pamundësohet prioritizimi i saktë nevojave për realizimin e projekteve për arritjen e objektivave të saj.

Gjithashtu, ASHI-ja nuk ka një plan për menaxhimin e kapacitetit për furnizim të institucioneve me VPN. Gjatë analizës së shfrytëzimit të kapacitetit të VPN-it për institucione, është identifikuar mungesa e një procedure të shkruar për përcaktimin e kapacitetit të nevojshëm të VPN-it që duhet të furnizohet një zyre/njësi/apo qendër e IRK-ve, në bazë të nevojave përfshirë numrin e përdoruesve, aplikacioneve dhe të dhënat që do të përdoren në rrjetë, etj.

Në disa raste, furnizimi me kapacitet të VPN-it 30 Mbps ishte njësoj si në zyre/njësi me pak staf dhe numër të ultë të kërkesave, ashtu edhe në një qendër/zyre me shumë staf dhe numër të lartë të kërkesave. Pra, nuk ka kriteret për kapacitet të VPN-it për zyre të IRK-ve. Kapaciteti për VPN për furnizim të një zyre/njësie përcaktohet në bazë të nevojës, pozitës gjeografike, infrastrukturës teknike dhe kërkesës që bëjnë zyrtarët e institucionit. Nëse kapaciteti i VPN është më i lartë, kostoja e saj është më e lartë.

Mungesa e një standardi për menaxhimin e kapacitetit për përcaktimin e furnizimit të institucioneve me VPN ishte për shkak të mungesës së stafit dhe angazhimeve për mbulimin

³⁹ Manuali i auditimit të Teknologjisë së Informacionit, matrica e auditimit mbi Zhvillimin dhe Blerjen.

⁴⁰ Rregullore (QRK) nr. 06/2018 për menaxhimin e projekteve në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, është miratuar në mbledhjen e 39 të - Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendim Nr.04/39 me datë 04.04.2018

e nevojave të rrjetit për të gjitha institucionet. Kjo mund të ndikon në menaxhim jo të mirë të kapacitetit të rrjetit.

9. ASHl-ja nuk ka trajtuar mjaftueshëm çështjen e sigurtisë së informacionit në realizimin e projekteve të TI-së

Kërkesat e sigurtisë së informacionit të organizatës duhet të jenë të përcaktuara ndaj kontraktorit në mënyrë të përshtatshme dhe t'i përfshijë ato në kontratë dhe deklaratë të konfidencialitetit.⁴¹

Në analizën e dosjes së tenderit, ofertës së OE-së dhe kontratës për furnizim me Internet dhe VPN u identifikua që ASHl-ja në specifikimin teknik nuk kishte kërkuar që rrjeti i dedikuar për ASHl-në nuk duhet të kalojë nga kanale/rrjete të cila nuk janë të sigurta për vendin tonë. ASHl-ja ka pohuar se kjo kërkesë ishte një kriter i rëndësishëm për ta dhe sigurinë e informacionit. Megjithatë gjatë përgatitjes së termeve të referencës nga grupi teknik kjo kërkesë nuk ishte vendosur. Inicimi i kësaj kërkesë për prokurim me mungesë të këtij kriteri ishte miratuar nga drejtori i përgjithshëm i ASHl-së. Në ofertën e OE-së fituese të projektit, ishin deklaruar dy sisteme autonome si lidhje fizike për shkëmbimin e trafikut ndërmjet rrjeteve të ndryshme (interkoneksion ndërkombëtar rajonal): Telekom Serbia dhe Shqipëria. Për të parandaluar që trafiku i internetit të kalojë nga Serbia, ASHl-ja kishte kërkuar konfirmim nga OE-ja që trafiku i internetit nuk kalon nga Serbia.

Mos përfshirja e kriterëve për siguri të informacionit rrezikon ekspozimin e IRK-ve ndaj rrjedhjes së informacionit.

Gjithashtu, ASHl në asnjërin nga kontratat e mirëmbajtjes së pajisjeve të TI-së në QShDh nuk ka paraparë të nënshkruajnë deklaratë konfidencialiteti për punonjësit e OE-ve që janë të angazhuar për kontratat përkatëse, edhe pse punonjësit në fjalë kanë qasje në QShDh, në pajisjet për nxjerrjen e log-ave dhe ndërrimin e disqeve të serverëve.

Deklaratën e konfidencialitetit ASHl-ja e ka praktikuar në rastet kur nuk kanë pas kontratë të drejtpërdrejtë me OE-në i cili ka nënkontraktuar kryerjen e shërbimeve për ASHl-në si dhe për stafin e tyre të brendshëm të cilët janë të angazhuar në qendrën e thirrjeve për platformën e-Kosova. Ndërsa, kur kanë kontratë me OE-në, atëherë mbështetën në kontratën e prokurimit dhe nuk obligojnë stafin e angazhuar nëpërmjet OE-së të nënshkruajnë deklaratën e konfidencialitetit.

ASHl-ja në mungesë të nënshkrimit të deklaratës së konfidencialitetit rrezikon në trajtimin e informacionit i cili konsiderohet konfidencial, që stafi i OE-ve i cili ka qasje në to nuk e kupton rëndësinë e mbrojtjes së informacionit, detyrimet dhe dënimet në rast të shkeljeve ligjore dhe kontraktuale, si dhe rrezikon shpалosjen e informacionit zyrtarë.

⁴¹ Manuali i auditimit të Teknologjisë së Informacionit, matrica e auditimit mbi Zhvillimin dhe Blerjen.

4. Konkluzionet

ASHI-ja nuk bënë identifikim të qartë të kërkesave dhe nevojave për projekte të reja për investime në TI. Mungon prioritizimi i qartë dhe analiza e kostos për ndarjen e buxhetit për projekte të cilat ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve për arritjen e objektivave të Agjencisë dhe IRK-ve. Qendra për rimëkëmbje nga fatkeqësitë për IRK-të ende nuk është siguruar. Ka raste që projekti nuk ishte iniciuar në kohë, me arsyetimin e buxhetit jo të mjaftueshëm edhe pse çdo vit ishte i vendosur në planin e prokurimit. Andaj, buxheti dhe projektet për investime në TI nuk janë orientuar sipas prioriteteve. Këto mangësi kanë ndikuar që IRK-të të iniciojnë projekte të njëjta në mungesë të përkrahjes nga ASHI-ja duke rrezikuar dyfishimin e projekteve dhe ndikon në rritjen e kostos për këtë fushë në nivel vendi.

Projektet e ASHI-së janë iniciuar dhe realizuar pa marr pëlqimin e komisionit për vlerësimin e projekteve. Gjithashtu, ASHI-ja nuk bënë analizë për parashikim të çmimeve, ka projekt në ASHI që është bërë parashikimi i vlerës së çmimit më të lartë se oferta dhe çmimi i tregut. Kjo ka rezultuar që të paguhen shërbime/produkte më vlerë më të lartë se vlera reale e tregut.

Nuk ka politikë për hartimin e planit për menaxhimin e rrezikut të TI-së. Si pasojë, ASHI-ja është përballur me probleme në ndërprerjen e shërbimeve të internetit për të gjitha IRK-të. Kjo mund të ndikojë edhe në humbje të reputacionit si dhe në dëme financiare për institucionet për të cilat japin shërbime.

ASHI-ja në projektet e saj ka kërkuar realizime të e-shërbime/sistemeve, si dhe blerje të licencave të Microsoftit pa vlerësuar dhe arsyetuar blerjen dhe zhvillimin e tyre. ASHI-ja ka blerë sisteme të cilat nuk i shfrytëzon në mënyrë efikase. Kjo ka rezultuar në investime të panevojshme dhe orientim jo të mirë të parasë publike. Këto investime nuk kanë ndikuar në zbutjen e rreziqeve të TI-së dhe në përmbushjen e objektivave të Agjencisë.

Gjatë zbatimit të projektit e-Kosova, monitorimi dhe komunikimi me palët e interesit (IRK-të) nuk është realizuar në kohë, duke rezultuar me mosrealizimin e shërbimeve të planifikuara. Gjithashtu, ndërlidhja e disa shërbimeve nuk është realizuar nëpërmjet GG platformës, duke rrezikuar sigurinë e informacionit dhe kostot shtesë. Për zhvillimet e shërbimeve të cilat kanë ardhur me kërkesë nga Qeveria, nuk është bërë një analizë për kompleksitetin dhe koston për zhvillimin e tyre, para ekuivalentimit me shërbimet tjera. Si rrjedhojë, Agjencia ka bërë porosi vlerën totale të kontratës pa bërë një analizë të kostos për zhvillimin e shërbimeve të ekuivalentura dhe mundësinë për kursimin e buxhetit.

ASHI-ja në kuadër të projektit e-Kosova ka pranuar dhe paguar në vlerë 219,415 euro, sistem për ruajtjen dhe rikthimin e të dhënave, por ky sistem ishte integruar në platformë pas përfundimit të kontratës. . Për më tepër, testimi i pranueshmërisë ishte kryer vetëm nga një anëtar i grupit teknik dhe kishte raste që testimet e sistemit ishin realizuar pas lansimit të shërbimeve në platformë.

Po ashtu, ky projekt kishte mangësi që ndërlidhen me reduktimin e konkurrencës në mesin e OE-ve. Në dosjen e tenderit ASHI-ja ka vendosur kërkesa që kufizojnë konkurrencën (diskriminuese) në lidhje me mundësitë teknike dhe/ose profesionale të ofertuesve. Lidhur me këtë kriter kanë reaguar edhe OE-të e interesuar për këtë projekt. Si rrjedhojë, njëri nga ofertuesit ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit që ndërlidhet me këtë kriter.

Agjencia ka bërë porosi për licenca të Microsoft për shkolla që nuk janë shfrytëzuar/aktivizuar. Për periudhën 2018-2020 janë bërë shpenzime të panevojshme për këto porosi në vlerë prej 440,973 euro duke shkaktuar dëme financiare. Ndërsa, për licencat Microsoft për nevoja të IRK-ve, për periudhën 2018-2020 nuk kishte raport të saktë të shpërndarjes së licencave, për të vlerësuar nevojën e porosisë për vitin pasardhës, që mund të ndikojë në porosi të licencave të panevojshme. Po ashtu Agjencia për përkrahje teknike vjetore ka paguar në vlerë 56,640 euro, për 200 orë. Këto pagesa janë realizuar pa pranuar raport të numrit të realizuar të orëve për përkrahje teknike nga Microsoft.

Pra, ASHl-ja në të shumtën e rasteve ka bërë kontrata kornizë të cilat nuk i ka tejkaluar, por nuk ka shfrytëzuar mundësitë për mos realizimin e tyre +/- 30% dhe si pasojë ka bërë shpenzime të pa arsyetuara drejtë dhe të panevojshme edhe për shërbimet e pa realizuara, duke mos kursyer buxhetin.

ASHI ka zhvilluar dy projekte me procedurë të hapur që ndërlidhen më një kontratë që paraprakisht e kishte klasifikuar/shënjuar kontratë konfidenciale, pa e rivlerësuar dhe deklasifikuar atë fillimisht sipas legjislacionit.

ASHl-ja nuk i përmbahet plotësisht rregullores për menaxhimin e projekteve të TIK-ut, e cila ka përgjegjësi mbajtjen e regjistrave të projekteve për të gjitha IRK-të. Si pasojë, nuk ka një portfolio të plotë të projekteve të realizuara nga ASHl-ja.

Po ashtu, ASHl-ja nuk ka një standard për përcaktimin e kapacitetit për furnizim me VPN për IRK-të. Kjo mund të rezultojë në një menaxhim jo të mirë të kapacitetit të rrjetit VPN.

ASHl-ja nuk ka trajtuar me kujdes çështjet lidhur me sigurinë e informacionit. Në zhvillimin e projekteve nuk ka përcaktuar kërkesën për të kufizuar trafikun e internetit që kalojnë nga vende të pasigurta përmes interkoneksionit rajonal. Gjithashtu, nuk ka zbatuar nënshkrimin e deklaratës së konfidencialitetit për të gjithë stafin e OE-ve që kanë qasje në informacionin dhe infrastrukturën e TI-së.

5. Rekomandimet

Ministria e Punëve të Brendshme dhe Agjencia e Shoqërisë së Informacionit duhet të sigurojnë që:

1. **Identifikimi, përcaktimi dhe aprovimi i kërkesave të TI.** Të krijojnë një plan/proces të strukturuar për identifikimin e nevojave të TI-së dhe propozimin e zgjidhjeve konkrete për të përcaktuar ato që duhet të aprovohen. Të identifikohen prioritetet e projekteve në mënyrë që të aprovoni kërkesat më të rëndësishme në harmoni me buxhetin që ndihmojnë në arritjen e objektivave të organizatës;
 - 1.1 Në planin e propozuar të prokurimit janë prezantuar arsyetime të mjaftueshme dhe bindëse për projektet e reja në mënyrë që Ministria të ketë informacione të mjaftueshme për vendosjen e tyre në planin e prokurimit;
 - 1.2 Për çdo projekt të TIK-ut, duhet të iniciojë planin ideor te komisioni vlerësues i projekteve të TIK-ut për pëlqim/refuzim të projektit;
2. **Menaxhimi i rrezikut.** Të hartojnë dhe të zbatohet një plan i detajuar për menaxhimin e rrezikut në teknologjinë e informacionit. Plani duhet të azhurnohet dhe rishikohet në mënyrë periodike për të vlerësuar nëse investimet e bëra kanë ulur rrezikun ose ka rreziqe të reja që duhet të adresohen;
3. **Menaxhimi i projekteve të TI-së.** Për zhvillimin e sistemeve të TI-së të bëjë një analizë të fizibilitetit në mënyrë që të vlerësoj mundësitë teknike që sistemi mund të zhvillohet dhe zbatohet me sukses, të bëjë analizën e kost-benifitit për projektet e TI-së para se të aprovohen projektet. Po ashtu, gjatë zhvillimit të projekteve të TI-së të përcaktohet një metodologji e caktuar;
 - 3.1 Të bashkëpunojë me departamentet përkatëse të ASH-së dhe MPB-së për menaxhimin dhe planifikimin e projekteve në mënyrë që të bëjë një planifikim të projektit dhe parashikim të çmimit të jetë sa më i arsyeshëm dhe real;
 - 3.2 Në raste të Marrëveshjeve për marrjen e shërbimeve të analizohen nevojat dhe të orientohen në mundësitë më të favorshme të saj dhe zbatimi i tyre të jetë në harmoni me aktet/kontratat pasuese.
 - 3.3 ASH-ja të monitoron dhe vlerësojë projektet për të siguruar arritjen e kërkesave/shërbimeve mbi koston, shtrirjen kohore, performancën/kompleksitetin e projektit.
 - 3.4 Gjatë fazave të zhvillimit të projektit të bëhet monitorim dhe vlerësim i zhvillimit të projektit, si dhe të përditësoj planet e menaxhimit të projekteve sipas kërkesave dhe të bëjë raportimin për fazat e zbatimit të projekteve;
 - 3.5 Në kontratë specififikimin teknik të bëjë me të detajuar dhe ta zbërthej në elemente dhe për secilin element/komponentë të jap çmimin në mënyrë që realizimi i pagesës të bëhet vetëm për shërbimin e pranuar.

-
4. **Testi i pranueshmërisë.** Testimi i pranueshmërisë duhet të realizohet nga grupi teknik para lansimit të shërbimit/modulit, ndërsa pranimi i sistemit dhe pagesa duhet të bëhet pasi zbatimi i tij është realizuar në përputhje me kërkesat e paraqitura në dosjen e tenderit/kontratë dhe kërkesat e bëra nga përdoruesit;
 5. **Klasifikimi i informacionit.** Para se të iniciojë procedurat e hapura publike të prokurimit së pari duhet të shqyrtojë nivelin e klasifikimit të informacionit dhe të trajtojë atë sipas legjislacionit në fuqi;
 6. **Prioritizimi i kërkesave të përdoruesve/IRK-ve.** Të bëjnë listën e prioriteteve për zbatimin e projekteve në mënyrë që të ndihmojnë në mbulimin e nevojave më kritike të përdoruesve dhe të bëhet analizë e kostos për investimet në projekte në bazë të nevojave dhe t'i përmbahen afatit të fillimit të procedurave të prokurimit;
 7. **Kërkesat në dosjen e tenderit.** Dosja e tenderit duhet të përgatitet sipas rregullave të përcaktuara në mënyrë që nuk kufizon konkurrencën në mesin e OE-ve dhe/ose diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve;
 8. **Rregullorja për menaxhimin e projekteve të TI-së.** Të zbatojnë rregulloren për menaxhimin e projekteve të TI-së dhe të bëjë mirëmbajtjen e regjistrit të projekteve të realizuara për TIK;
 - 8.1 Të hartojnë një standard për menaxhimin e kapacitetit për furnizimin e IRK-ve, duke identifikuar saktësisht nevojat e tyre për kapacitetin e nevojshëm;
 9. **Trajtimi i sigurisë së informacionit.** Në përcaktimin e termave të referencës/specifikimit teknik, duhet të përcaktojë kërkesat në lidhje me trafikun e internetit nëpërmjet interkoneksionit ndërkombëtar që është i nevojshëm për sigurinë kombëtare; dhe
 - 9.1 Të zbatojnë nënshkrimin e një deklaratë të konfidencialitetit nga të gjithë punonjësit, kontraktorët dhe palët e jashtme përpara se të lejohen të kenë qasje në sistemet e TI-së dhe ambientet e punës së AShI-së dhe duhet të sigurojë që informacioni i mbajtur konfidencial të mos zbulohet ose përdoret pa lejen e nevojshme.

Rekomandimet ndërlidhen me gjetjet e paraqitura dhe çështjet brenda tyre që si rrjedhojë janë 18 rekomandime

Shtojca I. Dizajni i auditimit

Fushat me rrezik dhe motivi i auditimit

Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, si institucion përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në IRK, duke i'u referuar prioriteteve strategjike të Republikës së Kosovës⁴² është orientuar në planifikimin dhe përcaktimin e projekteve lidhur me transformimin digjital të shërbimeve në sektorin publik, me qëllim të përmirësimit të proceseve të punës dhe lehtësimin e shërbimeve për qytetarët.

ASHI-ja për të arritur objektivat strategjike ka realizuar projekte për investime në sistemet e informacionit për centralizimin e shërbimeve dhe ndërveprimin të sistemeve në nivelin, Qeveria për Qeverinë, Qeveria për qytetarët dhe Qeveria për biznesin, në zgjerimin e shërbimeve të internetit në IRK, në siguri dhe mbrojtje të infrastrukturës komunikuese elektronike, etj.

Gjatë fazës së parastudimit të auditimit dhe intervistave të realizuara me zyrtarët përgjegjës në ASHI, për të vlerësuar ciklin e zhvillimit të projekteve të teknologjisë së informacionit kemi identifikuar rreziqet si më poshtë:

- Nuk kanë plan të menaxhimit të rrezikut për organizatën, rrjedhimisht prioritizimi i projekteve nuk është realizuar sipas rrezikut;
- Mangësi në identifikimin e nevojave për blerjen dhe zhvillimin e projekteve, rrjedhimisht mungon analiza e fizibilitetit dhe identifikimi i ndërlidhjeve me sistemet tjera të nevojshme, si dhe në identifikimin e e-shërbimeve të tjera para inicimit të projektit;
- Nuk është bërë një analizë e mirëfilltë e tregut në përcaktimin e vlerës së përafërt të çmimit për zhvillime të projekteve;
- Lidhja e kontratave pa qenë në plan të projekteve të prokurimit;
- Mos realizimi i planit të prokurimit, si pasojë ASHI-ja ende nuk ka qendër të rimëkëmbjes;
- Mungon monitorimi për përdorimin e licencave si dhe pagesat për përkrahje teknike janë realizuar pa raport të numrit të orëve;
- Parashtrimi i kërkesave diskriminuese për OE-të që kryejnë shërbime të njëjta;

ASHI-ja ka bërë disa herë projekte të ndryshme të interoperabilitetit për ndërlidhjen e sistemeve por ato ende nuk janë të ndërlidhura, për më tepër në skanimin e gjendjes së TI-së në IRK-të që ka bërë një grup punues nga ASHI-ja janë hasur edhe sisteme të dyfishta. Përveç në IRK, mangësi në ndërlidhjen e sistemeve kemi hasur edhe në ASHI. Edhe pse është krijuar platforma e interoperabilitetit (GG Platforma) për ndërlidhjen e sistemeve, në projektin e-Kosova janë realizuar shërbime të gjendjes civile të cilat janë ndërlidhur drejtpërdrejt me ARC

⁴² Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021

dhe kanë anashkaluar ndërlidhjen me GG platformën. Gjë që ndikon në kosto të dyfishtë dhe cënim të sigurisë së informacionit;

- Për projekte që fillimisht janë klasifikuar dhe zhvilluar me procedurë të negociuar, me rastin e vazhdimit të projektit për licenca të pajisjeve, janë zhvilluar procedura e hapur duke cenuar shpalosjen e informata për pajisje nga projekti fillestar i klasifikuar.

Përveç këtyre çështjeve/problemeve, për këtë auditim ka parashtruar kërkesë Qeveria e Kosovës. Në bazë të diskutimeve me zyrtarë në MPB kërkesa për auditim nga Zyra Kombëtare e Auditimit ka rrjedhë pasi Ministria e Punëve të Brendshme ka bërë një raport të skanimit të gjendjes së IRK-ve në fushën e TI-së dhe ka vërejtur mungesë të mekanizmave monitorues dhe kontrollues për investimet në TIK dhe mosfunksionim të sistemeve të informacionit. Këto shqetësime janë shpalosur edhe në takimin me zyrtarët në MPB.

Shqyrtimi i treguesve të problemit të identifikuar nga burime të ndryshme si dhe nga vlerësimet tona të bazuara në Manualin Aktiv të Auditimit të TI-së⁴³ për identifikimin e fushave më me rrezik nga dokumentacioni i pranuar dhe takimet e mbajtura me personat përgjegjës për identifikimin e nevojave për blerje dhe zhvillim dhe zbatim të sistemeve të informacionit na orienton në problemin kryesor në menaxhimin e projektit të sistemeve të informacionit.

Përshkrimi i sistemit

Misioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme është të kujdeset për sundimin e ligjit dhe sigurinë publike në tërë territorin e Republikës së Kosovës. MPB-ja përgatit dhe zbaton politikat e administrimit dhe komunikimit të sistemeve si një nga institucionet kryesore në Kosovë që mban të dhënat elektronike në aspektin e sasisë, cilësisë dhe rëndësisë, me agjencitë dhe organet e veta, të cilat janë tetë (8) duke e përfshirë edhe ASHI, si dhe trembëdhjetë (13) departamente dhe divizione.

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës në vitin 2013 ka miratuar ligjin 04/L-145⁴⁴ i cili përcakton ASHI si organin kryesor për zhvillimin dhe zbatimin e shërbimeve në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës. Strukturat përgjegjëse për shoqërinë e informacionit në institucionet e Republikës së Kosovës sipas këtij ligji janë ASHI si dhe Struktura përkatëse organizative apo Zyrtari për menaxhimin e TIK-ut në IRK-të.

Ligji për Organet Qeveritare të Shoqërisë së Informacionit, përcakton organet përgjegjëse për zhvillimin e shërbimeve të shoqërisë së informacionit, kompetencat, përgjegjësitë, organizimin dhe funksionimin e tyre pranë institucioneve të Republikës së Kosovës.

⁴³ Manuali Aktiv i Auditimit- është platformë e zhvilluar nga ITWG/EUROSAL dhe WGITA/INTOSAL, që përdoret për identifikimin e fushave më me rrezik, përcaktimin e pyetjeve, kriterëve dhe metodologjisë së punës gjatë procesit të auditimit të TI-së.

⁴⁴ Ligji Nr. 04/L-145 për Organet Qeveritare për Shoqërinë e Informacionit, shpallur me dekretin Nr.DL-021-2013, datë 02.05.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës.

AShI-ja është organ qendror i administratës shtetërore për zhvillimin dhe zbatimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për institucionet e Republikës së Kosovës dhe zhvillimin e projekteve të TI-së. Detyrat dhe përgjegjësitë e saj janë:

- Menaxhon dhe mbikëqyrë implementimin e projekteve të TIK-ut në institucionet e Republikës së Kosovës;
- Akumulon, administron, asgjëson dhe ruan të dhënat e prodhuara nga sistemet elektronike;
- Shqyrton kërkesat për projektet e planifikuara dhe monitoron implementimin e tyre në pajtim me politikat dhe Strategjinë e Qeverisjes Elektronike;
- Koordinon aktivitetet për sigurinë e shërbimeve elektronike.

Fazat e menaxhimit të projekteve të cilat duhet të ndjekë AShI-ja sipas rregullores për menaxhimin e projekteve në fushën e TIK-ut janë prezantuar në figurën 3. Procedurat e ngjashme të këtij procesi duhet të ndiqen edhe nga IRK-të.




Figura 3. Përshkrimi i fazave të projekti

Roli dhe përgjegjësitë e palëve

ASHI-ja është themeluar si agjenci ekzekutive qeveritare në kuadër të ministrisë përgjegjëse për administratën publike, ose pranë autoritetit më të lartë të administratës shtetërore të vendosur nga Qeveria dhe që tani është Ministria e Punëve të Brendshme.




Figura 4. Organizimi i ASH-së

Drejtoritë kryesore të ASH-së, secila me objektivat dhe detyrat e veta, janë:

- Drejtorati i Zhvillimit dhe Politikave të e-Qeverisjes;
- Drejtorati i Racionalizimit të Proceseve Administrative;
- Drejtorati i Administrimit dhe Zhvillimit të Sistemeve Elektronike;
- Drejtorati i Shërbimeve Qendrore dhe Sigurisë; dhe
- Drejtorati i Rrjetit Shtetëror.

Drejtorati i Zhvillimit dhe Politikave të e-Qeverisjes është përgjegjës për krijimin e politikave dhe standardeve dhe për monitorimin e zbatimit të tyre. Identifikon dhe i renditë kërkesat dhe nevojat e institucioneve të Administratës Publike për e-qeverisje në fushat sikurse janë sistemet informative, siguria e sistemeve, bazat e të dhënave, dhe zhvillimi i shkathtësive të TI-së. Prioriteti kryesor aktual i Drejtorisë së e-qeverisë është zbatimi i interoperabilitetit të sistemeve ekzistuese në institucione. Plani për një zbatim të tillë synon identifikimin e ndërveprimit potencial dhe teknik për zbatimin e tij.

Drejtoria e Administrimit dhe Zhvillimit të Sistemeve Elektronike menaxhon dhe administron sistemet e e-qeverisë të përdorura nga institucionet e Administratës Publike. Është përgjegjëse për inicim të projekteve të cilat synojnë zhvillimin e softuerit i cili i automatizon proceset administrative, shërbimet publike dhe ndërveprimin mes sistemeve. Ky drejtorat është po ashtu përgjegjës për specifikimin e kërkesave të cilat e definojnë softuerin, duke përfshirë arkitekturën, modelet, proceset, shërbimet etj. Drejtoria e menaxhimit dhe integritetit të sistemeve luan një rol thelbësor në AShI për sigurimin e infrastrukturës si shërbim për institucione. Objektiva e tyre është të ofrojë softuerin si shërbim në të ardhmen.

Drejtoria e Shërbimeve Qendrore dhe Sigurisë menaxhon sistemin informativ qeveritar dhe qendrën e të dhënave. Gjithashtu menaxhon Infrastrukturën Private Kyçe ashtu që përdoruesit dhe ofruesit e shërbimeve elektronike mund të verifikohen. Ata i monitorojnë vazhdimisht shërbimet në proces për sa i përket vazhdimësisë, disponueshmërisë dhe sigurisë së sistemeve të TI-së.

Drejtoria e Rrjetit Shtetëror është kryesisht përgjegjës për operimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit qeveritar. Rrjeti shtetëror është vendosur aktualisht dhe mbulon pothuajse çdo regjion në Republikën e Kosovës. Ky është një rrjet i bazuar në fibër optik. Kjo drejtori, gjithashtu menaxhon shërbimet e ofruara nga operatorët lokal të telekomunikimit.

Divizioni i Prokurimit në MPB

Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Prokurimit janë:

- Përgatitë, koordinon dhe zbaton planin vjetor të ministrisë në fushën e prokurimit publik, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- Siguron që të gjitha kërkesat e prokurimit janë përgatitur në përputhje me rregullat dhe procedurat e prokurimit;
- Përcakton metodologjinë e prokurimit për tender dhe procedurat e vlerësimit të çmimeve;
- Ofron këshilla dhe asiston menaxhmentin në marrjen e vendimeve lidhur me çështjet kontestuese që mund të dalin në rastet e ekzekutimit të kontratave.

Udhëheqësi i Divizionit të Prokurimit raporton tek Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë, tani MPB-së.

Fushëveprimi dhe pyetjet e auditimit

Fushëveprimi i këtij auditimi do të jetë:

AShI-ja e cila është përgjegjëse për identifikimin, planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e projekteve për zhvillimin e sistemeve për e-qeverisje, zgjerimin e shërbimeve të internetit në IRK-se, akumulimin, administrimin, përhapjen dhe ruajtjen e të dhënave, sigurinë dhe mbrojtjen e infrastrukturës komunikuese elektronike dhe të të dhënave

Divizioni i Prokurimit i cili është përgjegjës për përgatitjen, koordinimin dhe zbatimin e planit vjetor të prokurimit në MPB. Fushëveprimi ynë do të bazohet në kërkesat e manualit për auditimin e TI-së dhe kriteret për blerjen dhe zhvillimin e sistemeve të TIK-ut. Puna e divizionit të prokurimit dhe procesi e vlerësimit të ofertave nuk janë fokus i yni.

Fokus i auditimit do të jetë planifikimi, menaxhimi dhe monitorimi i projekteve për sistemet e TIK-ut. Auditimi do të mbulojë periudhën nga viti 2019 deri në vitin 2022. Periudha dhe fokusi i auditimit janë bazuar në nivelin e shpenzimeve dhe rreziqeve të identifikuara gjatë kësaj periudhe, si dhe kërkesa e bërë për auditim nga MPB-ja.

Pyetjet e auditimit

Për t'iu përgjigjur objektivit të auditimit ne kemi parashtruar pyetjen kryesore të auditimit dhe nën pyetjet si në vijim:

Si i planifikon, menaxhon dhe monitoron ASHl-ja projektet e TIK-ut për të arritur objektivat e organizatës dhe si këto sisteme funksionojnë në raport me përmbushjen e kriterit?

Nën pyetjet audituese:

1. *Si i identifikon dhe aprovon ASHl-ja kërkesat e biznesit dhe të TI-së?*
2. *Si i menaxhon ASHl-ja rreziqet dhe investimet në TI ?*
3. *Si i identifikon, prioritarizon ASHl-ja kërkesat e përdoruesit për sistemet e TI-së dhe si i menaxhon ato?*
4. *Si i menaxhon dhe kontrollon ASHl-ja zhvillimin ose blerjen e projekteve të aprovuara për TI-në?*
5. *Si i menaxhon konfigurimin e produkteve të punës ASHl-ja të lidhura me zhvillimin dhe blerjen?*
6. *Si i adreson ASHl-ja kërkesat e sigurisë në procesin blerjes dhe zhvillimit të projektit?*

Kriteret e auditimit⁴⁵

Kriteret e përdorura në këtë auditim rrjedhin nga Manuali Aktiv i Auditimit të TI-së, Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës dhe Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik.

Për të vlerësuar menaxhimin e projekteve të ASH-së dhe funksionimin e sistemeve nga identifikimi i nevojave, planifikimi e deri te zbatimi i projekteve dhe monitorimi i tyre janë vendosur kriteret e mëposhtme:

- ASH-ja ka një plan se si të identifikojë kërkesat e reja të biznesit ose nevojat e TI-së dhe menaxhmenti i cili aprovon kërkesat, ka informacion të mjaftueshëm për vendimmarrje;
- Organizatat duhet të menaxhojnë projektet dhe investimet e tyre të TI-së, me qëllim të maksimizimit të përfitimeve dhe konsiderimin e elementëve, të tillë si rrezikun, kapacitetet, dhe prioritizimi në mes investimeve konkurruese;
- Organizata duhet të përllogaritë vlerën e parashikuar për një kontratë publike para inicimit të procedurës së prokurimit. Paralogaritja e tillë duhet të jetë e arsyeshme dhe reale për kontratën e parashikuar nga aspekti i efikasitetit, efektivitetit të kostos, dhe përdorimit transparent dhe të drejtë të fondeve dhe resurseve publike.
- Organizata ka politika dhe plane të menaxhimit të rrezikut, si dhe ka përcaktuar burimet e mjaftueshme për të identifikuar dhe menaxhuar rreziqet;
- Organizata ka plane ose procedura sesi të mbledhë, të rishikojë dhe të kategorizojë kërkesat për funksionalitete të reja ose të shtuara;
- ASH-ja për zhvillimin e çdo projekti duhet të bazohet në një planifikim paraprak, të bëjë "Përcaktimin e nevojave që duhet përmbushur" sipas ligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës;
- Organizata analizon, priorizon dhe menaxhon kërkesat për t'u siguruar se nevojat e përdoruesve janë plotësuar në mënyrë optimale dhe me kosto efektive;
- Autoriteti kontraktues duhet që dosjen e tenderit ta përgatit në mënyrë që nuk kufizon konkurrencën në mesin e OE dhe/ose diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve;
- Organizata ka një plan menaxhimi projektsh ose ekuivalent me të për çdo projekt të aprovuar, i cili udhëzon ekzekutimin e projektit;
- Organizata kontrollon dhe monitoron në mënyrë efektive projektet për tu siguruar në arritjen e kërkesave mbi koston, shtrirjen kohore dhe performancën e tyre;

⁴⁵ Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit është produkt i grupeve të punës së teknologjisë së informacionit të EUROSAT-t (WGITA) si dhe Iniciativës për zhvillim të INTOSAI-t (IDI) për përcaktimin e rregullave e standardeve të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.- më tej Manuali i auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

- Aktivitetet e menaxhimit të projektit përfshijnë menaxhimin e rreziqeve të lidhura me projektin dhe ndërmarrjen e aktiviteteve të përshtatshme të reduktimit të tyre;
- Aktivitetet e menaxhimit të konfigurimit kryhen në pajtim me politikat ose procedurat organizative;
- Vetëm ndryshimet e autorizuara dhe të aprovuara do të prezantohen në mjedisin e prodhimit;
- Kërkesat e sigurisë së organizatës janë theksuar nga kontraktori në mënyrë të përshtatshme

Metodologjia e Auditimit

Për t'iu përgjigjur pyetjes dhe nën pyetjeve audituese dhe me qëllim të mbështetjes së konkluzioneve të auditimit do të zbatojmë metodologjinë në vijim:

- Analiza e dokumenteve të kërkesave të reja për projekte dhe aprovimin i tyre;
- Rishikimi i planit ose procedurave të menaxhimit të kërkesave për të siguruar se përdoruesit, palët e interesit, ose të tjerë, janë të përfshirë në identifikimin e kërkesave;
- Rishikimi i portfolios së projekteve të prioritarizuara;
- Analizimi i raporteve të projekteve dhe analiza e kost benifitit;
- Rishikim i planit të menaxhimit të rrezikut të TI-së, rishikimi i duplikim procesverbaleve të mbledhjeve për t'u siguruar se rreziqet e reja janë të përfshira dhe të analizuar në mënyrë të përshtatshme dhe rreziqet e TI-së nëse monitorohen mbi baza periodike;
- Rishikim i mostrave të kërkesave për t'u siguruar se ekziston një rishikim fillestar dhe se kërkesat e ngjashme ose të dyfishuara janë grupuar;
- Rishikimi i kërkesave për të përcaktuar se ato përmbajnë autorin, datën, prioritetin, koston, rrezikun dhe elementë të tjerë;
- Rishikimi i kritereve për prioritarizimin e kërkesave për të vlerësuar nëse ato përmbajnë elemente lidhur me kostot, nevojat e biznesit, çështjet emergjente dhe kapacitetet e reja;
- Planifikimet e prokurimit të AShI-së për vitet 2019-2022;
- Ligji mbi ndarjen buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitet 2019-2022;
- Analiza e dosjeve të projekteve të përzgjedhura për verifikim nga iniciimi deri në zbatim dhe vlerësim;
- Krahasimi i projekteve të reja me ato të përfunduara, të cilat kanë aktivitet të njëjtë në rastet kur çmimet e projekteve kanë diferenca të mëdha;

-
- Rishikim i strukturës organizative të projektit për të përcaktuar detyrat e individëve përgjegjës për sigurimin e cilësisë ose testimin, zhvillimin, dhe instalimin e sistemit në infrastrukturën e TI-së, të organizatës, grupin mbështetës, etj;
 - Për projektet e furnizuara/ të blera listat e planeve për mbikëqyrjen e përgjithshme dhe rishikimi se çdo material i sjellë prej tyre është i aprovuar;
 - Analiza e projekteve me cilën metodë SDLC është përdorur/duke u përdorur në zhvillimin e projektit. Krahasimi i kostos së projektit dhe baza e shtrirjes kohore me raportet e statusit për të vlerësuar shmangiet, nëse ka;
 - Rishikim i planit të menaxhimit të projektit ose planit të menaxhimit të rreziqeve për të përcaktuar nëse rreziqet janë identifikuar për këtë projekt, rreziqet janë kategorizuar dhe i janë caktuar individëve ose grupeve të ndryshme për t'u monitoruar ose reduktuar sipas mënyrave më të përshtatshme;
 - Rishikimi i politikave të menaxhimit të konfigurimit të projekteve;
 - Sigurimi se ekziston grupi për autorizimin e ndryshimeve ndaj produkteve të punës i cili rishikon dhe aprovon ndryshimet e projektit;
 - Analiza e dokumenteve për realizimin e testeve të sistemeve për t'u siguruar se programi është testuar, plotëson kriteret e pranimit, ka dokumentacion të përshtatshëm dhe përfshinë trajnim për përdoruesit;
 - Rishikim të dokumenteve për të vlerësuar se kërkesat e sigurisë janë identifikuar prej organizatës dhe janë hartuar në kontratë ose në SLA;
 - Zhvillimi i intervistave me zyrtarët përgjegjës.

Dokumentet relevante

Lista e ligjeve dhe rregulloreve relevante për këtë auditim:

- Ligji Nr. 04/L-145 për Organet Qeveritare për Shoqërinë e Informacionit;
- Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës;
- Rregullore (QRK) Nr. 02/2016 për Koordinim në mes të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit dhe Strukturave Organizative/ Zyrtarëve të Teknologjisë së Informacionit dhe e Komunikimit në Institucionet e Republikës së Kosovës;
- Rregullore (MAP) Nr. 02/2015 për Standarde për Softuer dhe Harduer;
- Rregullore (QRK) Nr. 06/2018 për Menaxhimin e Projekteve në Fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit;
- Rregullat dhe udhëzuesi operativ për prokurim public.

Shtojca II. Lista e projekteve që janë audituar

Në vijim është prezantuar lista e projekteve që janë audituar, që janë përzgjedhur nga rëndësia e sistemeve, çmimi dhe identifikimi i probleme gjatë fazës së parastudimit.

Nr.	Emri i Sistemit të Informacionit	Liferuesi / Zhvilluesi / Furnizuesi	Numri i kontratës	Data (nga-deri)		Kosotoja në €
1	Furnizimi me licenca për IRK LOT1	Cactus sh.a	202/17/080/111	05.12.2017	31.12.2020	9,529,147
2	Furnizimi me licenca MS /Lot2 Furnizim me licenca të MS për Universitete 2018,2019,2020	PBC Kosova	202/17/080/111	05.12.2017	31.12.2020	1,945,196
3	Mirëmbajtja dhe servisimi i pajisjeve për TI në QSHDH-ASHI	INFOSOFT SYSTEM sh.P.k & ITD	202-19-1197-2-1-1	09.12.2019	09.12.2022	117,967
4	e-Kosova	PBC	202-19-3193-2-1-1	26.12.2019	26.12.2022	2,976,510
5	Shërbimete Furnizime alternative backup për VPN dhe Internet për nevoja të IRK-ve	TelKos L.L.C	202-19-9495-1-1-	26.02.2020	25.02.2023	360,000
6	Vazhdimi i Licencave të Pajisjeve të Sigurisë Kibernetike - CISCO	NOVUS	214-21-10599-1-1-1/C155	09.03.2021	09.03.2024	588,713
7	Mirëmbajtja dhe servisimi i pajisjeve të TI- QSHDH- komponentët e TI-së- Ritender	Infsoft Systems SHPK	214-20-8603-2-1-1/C82	06.08.2021	06.08.2024	135,000
8	Furnizimi me licenca softuerike për monitorim dhe siguri	VIRTUO	214-22-1582-1-1-1/C234	24.05.2022	24.05.2025	523,800
9	Mirëmbajtja e pajisjeve të Ti-se në QSHDH (VXBLOCK)	NOVUS SHPK	214-22-2501-2-1-1	01.08.2022	01.08.2025	178,880
10	Sistemi Telefonik VoIP	"Cactus" sh.a	214-22-5153-1-2-1/C225	25.08.2022	25.08.2023	74,161
11	Solucion for SIEM (Security, Information And Event Management)	Infsoft System	214-22-1582-1-1-1/C235	30.08.2022	30.08.2025	134,095
12	Furnizimi me licenca softuerike për monitorim dhe siguri- menage engine AD Manager plus, menage engine log360, ad audit	Infsoft System	214-22-8778-1-1-1/C254	14.10.2022	13.10.2025	89,531
Vlera totale e kontratave						16,653,000

Shtojca III. Letërkonfirmimi



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të teknologjisë së informacionit “Menaxhimi i Projekteve për Sistemet e Teknologjisë së Informacionit në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit”, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: Prishtinë 27.06.2023


I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar drafri raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit “Menaxhimi i Projekteve për Sistemet e Teknologjisë së Informacionit në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit” (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.



Xhelal Syca,
Ministër i Punëve të Brendshme



Zyra Kombëtare e Auditimit | Lagjja Arbëria | Rr. Ahmet Krasniqi, 210 | 10000 Prishtina

Republika e Kosovës